VENDIM
Nr. 285, datë 19.5.2021
PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK[1]
(*ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021*
ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 1.8.2024
ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, pika 2; 13, pika 1, shkronja "a"; 14, pika 3, 17, pikat 1 dhe 2; 21, pika 4, 23, shkronjat "c" dhe "gj"; 33, pika 2; 34, pika 2; 35, pika 3, 41, pika 2, 42, pikat 1 dhe 3, shkronja "a"; 43, pikat 1 dhe 4, shkronja "a"; 44, pika 1; 50, pikat 2 dhe 7, 54, pika 1, 56, pika 4, 57, pikat 1 dhe 2, shkronja "c",58, pika 2; 71, pikat 1 dhe 2, shkronja "c", 72, pika 1, 74, pika 1, 78, pika 3, 82, pikat 1 dhe 5,111, pika 1, 116, pika 4; 124, pika 6, 131, pika 2, e 132, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave të prokurimit publik, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Agjencia e Prokurimit Publik, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të hartojë dhe të miratojë dokumentet standarde të tenderit.

3. Vendimi nr. 914, datë 29.12.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohen autoritetet dhe entet kontraktore, të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", për zbatimin e rregullave të miratuara me këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

[1] Ky vendim është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, "Mbi prokurimin publik dhe që shfuqizon direktivën 2014/18/KE", të ndryshuar, me numër CELEX 32014L0024, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, faqe 65–242; - Direktivën 2014/25/BE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, "Për prokurimin nga entitete që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon direktivën 2004/17/KE", të ndryshuar, me numër CELEX 32014L0025, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 94, datë 28.3.2014, faqe 243–374;
- Direktivën e Këshillit 92/13/KEE, datë 25 shkurt 1992, "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative, në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit për procedurat e prokurimit të enteve që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit", të ndryshuar, me numër CELEX 31992L0013, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 76, datë 23.3.1992, faqe 14-20;
- Direktivën e Këshillit (89/665/KEE), datë 21 dhjetor 1989, "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative, në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike", të ndryshuar, me numër CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 395, datë 30.12.1989, faqe 33–35.

RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK

KREU I
AUTORITETI OSE ENTI KONTRAKTOR

Neni 1
Përgjegjësia e autoritetit/entit kontraktor

1. Autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike të përcaktuara për përdorim në prokurimet publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.162/2020, "Për prokurimin publik" (në vijim, LPP), të këtyre rregullave, dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim, APP), të dala në bazë dhe për zbatim të LPP-së.

2. Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të planifikojë në cilësi dhe në kohë nevojat e tij e fondet publike respektive dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2
Dokumentimi i procesit

1. Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera.

2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:

   a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;
   b) arsyet për zgjedhjen e një procedure të caktuar, nëse është rasti;
   c) argumentimin e kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike/termat e referencës [1]të përcaktuara në procedurën e prokurimit;
   ç) vlerën dhe mënyrën e përllogaritjes së vlerës, në përputhje me parashikimet e LPP-së dhe parashikimet në këto rregulla;

[1] Shtuar me VKM 498/2024

d) të gjitha kërkesat për sqarim për dokumentet e tenderit, përgjigjet e dhëna për këto kërkesa, si dhe modifikimet e bëra në këto dokumente, nëse është rasti;
dh) emrat dhe adresat e ofertuesve që kanë dorëzuar oferta;
e) emrin dhe adresën e ofertuesit, oferta e të cilit është përcaktuar si fituese, kur ka një të tillë, si dhe vlerën e kontratës;
ë) arsyet e kualifikimit dhe skualifikimit të ofertuesve ose kandidatëve;
f) procesin e hedhjes së shortit, nëse ka pasur;
g) arsyet e anulimit, sipas nenit 98, të LPP-së;
gj) argumentet për rastin kur një ofertë është refuzuar për shkaqe të parashikuara në nenin 76, pikat 3, shkronja "f", 4 dhe 5, të LPP-së;
h) argumentet për rastin kur një ofertë është kualifikuar për shkaqe të parashikuara në pikën 6, të nenit 76, të LPP-së;
i) ankesat dhe vendimmarrjes lidhur me to;
j) administrimin dhe verifikimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik fitues, në formë shkresore, përpara nënshkrimit të kontratës ose përpara nënshkrimit të marrëveshjes kuadër nga organi qendror blerës;
k) raport përmbledhës të ecurisë së procedurës, sipas parashikimeve në LPP;
l) planin e zbatimit të kontratës sipas parashikimeve të LPP-së[2];
ll) Raportin për zbatimin e kontratës, sipas parashikimeve në LPP[3].

3. Dokumentimi i proceseve që zhvillohen në sistemin e prokurimit elektronik bëhet automatikisht në sistem.

KREU II
REGJISTRI I PARASHIKIMEVE DHE REALIZIMEVE

Neni 3
Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik

1. Në bazë të nevojave për punë, mallra ose shërbime, autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për hartimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së.

2. Regjistri i parashikimeve duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimin në kohë të procedurave të prokurimit publik.

[2] Shtuar me VKM 498/2024

[3] Ndryshuar me VKM 498/2024

3. Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të nevojave, gjatë periudhës shtator – dhjetor të çdo viti, përgatit regjistrin për vitin ushtrimor në vijim, bazuar në ligjin që miraton parashikimet buxhetore afatmesme. Në çdo rast, afati maksimal i hartimit të regjistrit është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i detajimit të buxhetit[4].

   Autoritetit/enti kontraktor, brenda 5 (pesë) ditëve nga hartimi i regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit, duhet të dërgojë në organin qendror blerës të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës për objektet që do të prokurohen në mënyrë të përqendruar. Kur procedura e prokurimit do të kryhet nga organi qendor blerës apo ofruesi i shërbimit privat në emër dhe për llogari të autoritetit/entit kontraktor, ky i fundit përzgjedh njërin prej tyre, sipas rastit, në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit[5].

4. Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të krijojë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik dhe publikimi i zërave të tij nga APP-ja duhet të bëhet brenda 3 (tre) ditëve nga dita e nesërme e punës, nga dërgimi i tij për publikim në sistem.

   APP-ja, nëse vëren se regjistri i parashikimeve nuk është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik, kthen e këshillon autoritetin/entin kontraktor për hartimin e tij në përputhje me këto kërkesa.

   Një kopje e regjistrit të parashikimeve i vihet në dispozicion degës së thesarit dhe institucionit qendror, që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.

5. Çdo autoritet/ent kontraktor, i cili do të luajë rolin e organit qendror blerës, dhe autoriteti/enti, të cilit i është deleguar e drejta për prokurim (nëse është rasti), duhet të krijojnë një regjistër parashikimi për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen prej tyre, menjëherë me mbledhjen e të dhënave, por, në çdo rast, jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga marrja e kërkesave për prokurim nga autoritetet kontraktore.

   Në rast të marrjes së kërkesave për prokurim, të cilat nuk janë në përputhje me rregullat e prokurimit publik, organi qendror blerës ose autoriteti/enti, të cilit i është deleguar e drejta për prokurim, duhet të krijojë zërin e regjistrit brenda 5 (pesë) ditëve nga plotësimi ose saktësimi i të dhënave, nga autoritetet/entet kontraktore.

---

[4] Ndryshuar me VKM 498/2024

[5] Shtuar me VKM 498/2024

Organi qendror blerës dhe autoriteti, të cilit i është deleguar e drejta për prokurim (nëse është rasti), kanë detyrimin të krijojnë/të modifikojnë regjistrin e parashikimeve në sistemin e prokurimit elektronik. Publikimi i elementeve të tij nga APP-ja bëhet brenda 3 (tri) ditëve nga dita e nesërme e punës, nga dërgimi i tij për publikim në sistem[6].

6. Organet e pushtetit vendor, ndërmarrjet/shoqëritë me kapital mbi 50% shtetëror apo çdo autoritet/ent kontraktor tjetër jobuxhetor përgatisin regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik, bazuar në programet e zhvillimit ekonomik dhe në çdo rast jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit apo programet e zhvillimit ekonomik nga këshillat vendorë ose nga organet drejtuese përkatëse.

7. Autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste kur këto ndryshime vijnë për arsye që nuk kanë qenë të mundura të parashikohen në kohën e hartimit të regjistrit.

   Çdo ndryshim i regjistrit të parashikimeve bëhet nga vetë autoriteti ose enti kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik, dhe publikimi i tij nga APP-ja bëhet brenda 3 (tri) ditëve nga dita e nesërme e punës nga dërgimi i tij për publikim në sistem.

   APP-ja, nëse konstaton se ky ndryshim nuk është bërë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik, kthen dhe këshillon autoritetin/entin kontraktor për hartimin e tij në përputhje me këto kërkesa.

   Një kopje e këtyre ndryshimeve i vihet në dispozicion degës së thesarit dhe institucionit qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë.

Neni 4
Regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit

1. Në përfundim të çdo procedure prokurimi, pas lidhjes së kontratës krijohet regjistri i realizimeve të procedurave të prokurimit publik, në sistemin e prokurimit elektronik, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar në udhëzimet e APP-së.

[6] Ndryshuar me VKM 498/2024

2. Autoriteti/enti kontraktor, çdo katër muaj, por jo më vonë se datat 10 maj, 10 shtator dhe 10 janar të çdo viti, dorëzon në organet qendrore, që vënë në dispozicion fondet, një informacion të hollësishëm për procedurat e prokurimit të realizuara.

3. Në fillim të çdo viti, një kopje e regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit për vitin paraardhës, u dorëzohet organeve qendrore, që vënë në dispozicion fondet, jo më vonë se data 15 janar.

4. Regjistri Kombëtar i Procedurave të Prokurimit Publik të realizuara për vitin paraardhës gjendet i publikuar në faqen e internetit të APP-së.

5. Në përfundim të çdo procedure prokurimi të kryer nga organi qendror blerës apo ofruesit të shërbimit të prokurimit privat[7], pas lidhjes së kontratës, krijohet regjistri i procedurave të prokurimit të realizuara, në përputhje me formën dhe metodën e përcaktuar në udhëzimet e APP-së.

KREU III
NJOFTIME DHE PUBLIKIME

Neni 5
Llojet e njoftimeve

Njoftimet që publikohen në procedurat e prokurimit publik janë, si më poshtë vijon:

a) Njoftimi paraprak i informacionit;
b) Njoftimi periodik i informacionit;
c) Njoftimi mbi praninë e një sistemi kualifikimi;
ç) Njoftimi i kontratës/i konkursit të projektimit;
d) Njoftimi vullnetar i transparencës për procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
dh) Njoftimi mbi ndryshimet dhe informacionet shtesë në një procedurë;
e) Njoftimi i fituesit;
ë) Njoftimi i procedurës së anuluar;
f) Njoftimi i lidhjes së kontratës;
g) Njoftimi i ndryshimit të kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj.

Neni 6
Buletini i Njoftimeve Publike

[7] Shtuar me VKM 498/2024

1. APP-ja publikon Buletinin e Njoftimeve Publike çdo ditë të hënë. Në rastet kur dita e hënë përkon ditë pushimi, publikimi bëhet ditën e nesërme të punës.

   APP-ja publikon Buletinin e Njoftimeve Publike në çdo rast tjetër të parashikuar në akte të tjera ligjore ose me vendim të posaçëm të saj. Në fund të çdo muaji, një kopje elektronike e Buletineve të Njoftimeve Publike respektive, të publikuara çdo të hënë, i dërgohet Bibliotekës Kombëtare.[8]

2. Në Buletinin e Njoftimeve Publike publikohen, në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik:

   a) njoftimi i shkurtuar i kontratës për procedurat e prokurimit me vlerë mbi dhe nën kufijtë e ulët monetarë, sipas parashikimit të nenit 11, të këtyre rregullave;
   b) njoftimi i fituesit, njoftimi i kontratës së lidhur dhe njoftimi i anulimit;
   c) lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, si dhe arsyet e këtij përjashtimi, në bazë të nenit 78, të LPP-së[9];
   ç) çdo njoftim tjetër publik, informacion apo akt tjetër, që duhet të publikohet në përputhje me LPP-në dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 7
Rregulla të përgjithshme për formën dhe mënyrën e shpalljes së njoftimeve

1. Njoftimet e procedurave të prokurimit dhe konkursit të projektimit publikohen në përputhje me afatet e përcaktuara në LPP dhe në këto rregulla.

2. Njoftimet bëhen në sistemin e prokurimit elektronik dhe në mënyrë të shkurtuar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

   Njoftimet, sipas parashikimeve të nenit 56, të LPP-së, për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, publikohen edhe në gazetën zyrtare të Bashkimit Evropian.

3. Hedhja e njoftimit të kontratës, dokumenteve të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit të specifikimeve teknike/termat e referencës[10] dhe kritereve të veçanta të pranimit, në sistemin elektronik, bëhet nga vetë autoriteti/enti kontraktor. Në çdo rast, përmbajtja e këtyre dokumenteve duhet të përputhet

[8] Shtuar meVKM 498/2024

[9] Ndryshuar me VKM 498/2024

[10] Shtuar me VKM 498/2024

me versionin e miratuar dhe administruar nga autoriteti/enti kontraktor. Shpallja e njoftimit në sistemin e prokurimit elektronik do të bëhet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem.

4. Në njoftimet që publikohen sipas LPP-së, duhet të përfshihen të gjitha informacionet që u lejojnë operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë apo jo në procedurat e prokurimit. Në çdo rast, njoftimet do të bëhen sipas formatit, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit për çdo lloj procedure prokurimi.

5. Autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim, njoftimin e fituesit, në përputhje me parashikimet e nenit 97, të LPP-së, dhe njoftimin e lidhjes së kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës.

   Në rastin e prokurimit të përqendruar, autoriteti/et/enti/et kontraktor/e përfituese duhet të dërgojnë njoftimin e kontratës së lidhur pranë organit qendror blerës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës. Organi qendror blerës dërgon për publikim, njoftimin e kontratës së lidhur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga autoriteti/enti kontraktor.

   Në rastin e delegimit të prokurimit, autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e duhet të dërgojë/jnë njoftimin e kontratës së lidhur pranë autoritetit kontraktor, i cili ka zhvilluar procedurën e prokurimit, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të kontratës. Ky i fundit dërgon për publikim njoftimin e kontratës së lidhur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga autoriteti kontraktor.

6. Autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç është publikuar njoftimi i kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e përfundimit të afatit për paraqitjen e ankesave, ose dhënies së një vendimi përfundimtar për ankesën.

7. Hedhja në sistemin elektronik të njoftimit të fituesit, njoftimit të anulimit dhe njoftimit të kontratës së lidhur bëhet nga vetë autoriteti/enti kontraktor. Shpallja e njoftimit të fituesit, njoftimit të anulimit dhe njoftimit të kontratës së lidhur në faqen e internetit të APP-së do të bëhet publike jo më vonë se ditën e nesërme të punës, nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem.

8. Në rast se njoftimet e fituesit, njoftimet e anulimit dhe njoftimit e kontratës së lidhur nuk janë hartuar në përputhje me formën dhe mënyrën e përcaktuar në këto rregulla, APP-ja kthen e këshillon autoritetin/entin kontraktor për hartimin e tyre në përputhje me këto kërkesa.

9. Për të gjitha njoftimet që bëhen sipas LPP-së dhe këtyre rregullave në sistemin elektronik të prokurimit, afatet fillojnë të përllogariten nga dita pasardhëse e punës.

10. Afatet, kur nuk përcaktohen ndryshe në LPP dhe në këto rregulla, janë në ditë kalendarike, dhe përllogariten sipas përcaktimit në Kodin e Procedurave Administrative.

11. Në rastin kur procedura zhvillohet në formë shkresore, autoriteti/enti kontraktor është i detyruar të dërgojë për publikim në APP, me shkresë përcjellëse, një kopje të shkruar dhe elektronike (CD), të njoftimit të kontratës.

    Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor publikon, në faqen e tij zyrtare të internetit, dokumentet e tenderit dhe procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të pranimit. Autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për barazvlefshmërinë e kopjes së sipërpërmendur, së bashku me dokumentet e tenderit të hartuara nga njësia e prokurimit dhe që administrohen prej tij.

    Gjithashtu, në rastin kur, procedura zhvillohet në formë shkresore, autoriteti/enti kontraktor është i detyruar të dërgojë për publikim në APP, me shkresë përcjellëse, një kopje të shkruar dhe elektronike (CD) të njoftimit të fituesit, njoftimit të kontratës së lidhur dhe njoftimit të anulimit.

KREU IV
RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PROKURIMIT

Neni 8
Përjashtimet e veçanta

1. Shërbimet sipas përcaktimit në pikën 1, shkronja "ë", të nenit 7, të LPP-së, janë:

   a) Shërbimet e kërkimit e të zhvillimit, si dhe shërbimet e konsulencës të lidhura me to;
   b) Shërbimet e zhvillimit eksperimental;
   c) Projektimi dhe ekzekutimi i kërkimeve dhe zhvillimit;
   ç) Studimi i fizibilitetit dhe demonstrimi teknologjik;
   d) Testimi dhe vlerësimi.

2. Shërbimet, sipas përcaktimit në pikën 1, shkronja "g", të nenit 7, të LPP-së, janë, si më poshtë vijon:

a) Shërbimet e shpëtimit dhe ato të zjarrfikëses;
b) Shërbimet e zjarrfikëses;
c) Shërbimet e parandalimit të zjarrit;
ç) Shërbimet zjarrfikëse të pyjeve;
d) Shërbimet e shpëtimit;
dh) Shërbimet e mbrojtjes civile;
e) Shërbimet e sigurisë bërthamore;
ë) Shërbime ambulance.

3. Shërbimet, sipas përcaktimit në pikën 1, shkronja "h", të nenit 7, të LPP-së, janë, si më poshtë vijon:

a) Shërbime të fushatës reklamuese;
b) Prodhimi i filmit propagandistik;
c) Prodhimi i videokasetës/videoregjistrimeve propagandistike.

Neni 9
Kontratat e subvencionuara nga autoritetet kontraktore

1. Autoriteti kontraktor do të zbatojë rregullat e përcaktuara në LPP dhe këto rregulla, kur vendos të bashkëfinancojë, në masën 50% ose më shumë, kontrata pune për:

a) veprimtari të inxhinierisë së ndërtimit, sipas kodeve përkatëse në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;
b) punë ndërtimi për spitale, ambiente sportive, argëtimi dhe për kohën e lirë, ndërtesa shkolle e universiteti, dhe ndërtesa që përdoren për qëllime administrative.

2. Autoriteti kontraktor do të zbatojë rregullat e përcaktuara në LPP dhe këto rregulla, kur vendos të bashkëfinancojë, në masën 50% ose më shumë, kontrata shërbimi të lidhura me kontratat e punës të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni.

3. Vlera e parashikuar e kontratave sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, pa TVSH, duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se kufiri i ulët monetar.

4. Në rastin kur, kontrata e punës përballohet nga buxheti i autoriteteve kontraktore për më pak se 50% e fondit dhe vlera e parashikuar e të cilave, pa TVSH, është e barabartë ose më e vogël se kufiri i ulët monetar, autoritetet kontraktore detyrohen që në dhënien e këtyre kontratave të respektojnë parimet e përzgjedhjes të parashikuara në nenin 3, të LPP-së.

Në këtë rast, autoriteti kontraktor duhet të kujdeset që të paktën:

a) të përfshijë parashikimin për bashkëfinancimin në regjistrin e parashikimit;
b) të publikojë njoftimin për dhënien e kontratës sipas parashikimit në LPP dhe këto rregulla;
c) të respektojë parimet e parashikuara në LPP për trajtimin e operatorëve ekonomikë;
ç) të mbajë evidenca të plota për zbatimin e kontratës.

Neni 10
Format e komunikimit

Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit, si rregull, bëhet në përputhje me nenin 17, të LPP-së.

Autoriteti/enti kontraktor mund të komunikojë, në formë shkresore, vetëm në rastet e mëposhtme:

a) kur, për shkak të natyrës së veçantë të prokurimit, për komunikimin elektronik do të nevojiteshin pajisje, mjete apo formate të posaçme, të cilat nuk janë të disponueshme gjerësisht apo nuk suportohen nga aplikacione të disponueshme gjerësisht;
b) kur aplikacionet që suportojnë formatet e dokumenteve që janë të përshtatshme për përshkrimin e ofertave përdorin formate që nuk mund të trajtohen nëpërmjet aplikacioneve të hapura apo të disponueshme gjerësisht ose janë të regjistruara si pronësi intelektuale dhe nuk mund të vihen në dispozicion për t'u shkarkuar apo përdorur në distancë nga ana e autoritetit ose entit kontraktor;
c) kur për përdorimin e mjeteve elektronike të komunikimit nevojiten pajisje zyre të posaçme që nuk janë gjerësisht të disponueshme për autoritetet/entet kontraktore;
ç) për procedura prokurimi ose faza të tyre, të cilat kërkojnë dorëzimin e modeleve, projekteve ose maketeve, të cilët nuk mund të transmetohen nëpërmjet mjeteve elektronike.

Neni 11[11]
Kufijtë monetarë

1. Kufijtë monetarë janë vlera monetare në bazë të të cilave përcaktohen rregullat procedurale, kryesisht në përcaktimin e afateve kohore në

[11] Ndryshuar dispozita me VKM 498/2024

procedurat e prokurimit publik të sektorit klasik e sektorial për punë, shërbime, mallra, si dhe konkurset e projektimit.

2. Kufijtë monetarë ndahen në:

   a) kufiri i lartë monetar për sektorin klasik dhe kontratat sektoriale;
   b) kufiri i ulët monetar për sektorin klasik dhe kontratat sektoriale;
   c) kufiri monetar për shërbimet sociale dhe shërbime të tjera specifike;
   ç) kufiri monetar për prokurimet me vlerë të vogël.

3. Vlerat e kufijve monetarë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas parashikimeve të LPP-së.

4. Për veprimtari të përcaktuara në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, si dhe për artikuj dhe shërbime protokollare sipas legjislacionit në fuqi, përcaktohen rregulla të posaçme me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12
Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës

1. Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar, pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti/enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, duhet t'i mbajë ato parasysh kur përllogarit vlerën e prokurimit.

2. Autoriteti/enti kontraktor, në rastet e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, konverton vlerën limit të kontratës me një monedhë ndërkombëtare, të përzgjedhur prej tij sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën dërgohet për publikim njoftimi i kontratës. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor vendos dhe kursin e këmbimit të përdorur prej tij.

3. Përzgjedhja e metodës që përdoret për përllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të LPP-së dhe këtyre rregullave, apo për të copëzuar kontratën me qëllim shmangien e procedurave sipas kufijve monetarë.

4. Autoriteti/enti kontraktor, në fazën e hartimit të nevojave për mallra, punë ose shërbime mban në konsideratë, metodat e përllogaritjes së vlerës së prokurimit. Vlera e përllogaritur e prokurimit duhet të jetë vlerë reale e përllogaritur përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit.

5. Për marrëveshjet kuadër dhe sistemet dinamike të blerjes, vlera që do të merret parasysh është vlera maksimale e parashikuar pa TVSH, e të gjitha kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë afatit të marrëveshjes kuadër ose sistemit dinamik të blerjes.

6. Në rastin e partneriteteve për inovacion, vlera që duhet marrë në konsideratë është vlera maksimale pa TVSH, e veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit që do të kryhen gjatë të gjitha fazave të partneritetit të parashikuar, si edhe të furnizimeve, shërbimeve ose punëve që do të zhvillohen ose prokurohen në përfundim të partneriteteve të parashikuara. Vlera e parashikuar e mallrave, shërbimeve ose punëve, që synohen të përfitohen në këtë rast, duhet të jetë në proporcion me investimin që kërkohet për realizimin e tyre.

7. Në lidhje me kontratat publike për punë, llogaritja e vlerës së parashikuar merr në konsideratë koston e punëve dhe vlerën totale të parashikuar të furnizimeve dhe shërbimeve që vihen në dispozicion të kontraktorit nga autoriteti/enti kontraktor, nëse ato janë të nevojshme për kryerjen e punëve.

8. Kur një punë, mall ose shërbim mund të rezultojë në dhënien e disa kontratave në formën e loteve të veçanta, për qëllim të përllogaritjes së vlerës së kontratës, duhet të merret parasysh vlera e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve.

9. Në rastin e kontratave publike të furnizimit ose të shërbimit, që kanë natyrë të vazhdueshme ose me mundësi ripërtëritje brenda një periudhe të caktuar, përllogaritja e vlerës së kontratës bazohet:

   a) në vlerën e përgjithshme reale të kontratave të njëpasnjëshme të të njëjtit lloj, të dhëna gjatë vitit kalendarik ose gjatë 12 muajve paraardhës, vlerë e përshtatur, nëse është e mundur, në mënyrë që të merren parasysh ndryshimet në sasi ose vlerë që mund të ndodhin gjatë 12 muajve pas kontratës fillestare; ose
   b) në vlerën e përgjithshme të kontratave të njëpasnjëshme të dhëna gjatë 12 muajve pas dorëzimit të parë ose gjatë vitit ushtrimor, nëse është më i gjatë se 12 muaj.

10. Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti/enti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar. Autoriteti/enti kontraktor, në çdo rast, duhet të argumentojë aplikimin e kontratës shumëvjeçare dhe të bëjë një përllogaritje të saktë të fondit, ku të jepen hollësi për investimin që do të kryhet, amortizimin për çdo vit dhe përbërësit/elementet e tjera të ngjashme me to.

11. Në rastet e kontratave të furnizimit të mallrave, përmes qirasë me ose pa mundësi blerje të mallrave, fondi limit llogaritet duke përfshirë qiranë apo këstin mujor, shumëzuar me numrin e muajve, gjatë të cilëve do të zgjasë kontrata.

12. Për kontratat publike të shërbimit, baza për përllogaritjen e vlerës së kontratës është si më poshtë, sipas rastit:

    a) shërbime sigurimi: primi që duhet paguar dhe çdo formë tjetër pagese;
    b) shërbime bankare ose shërbime të tjera financiare: tarifat, komisionet që duhet të paguhen, interesi dhe forma të tjera të pagesës;
    c) kontratat e projektimit: tarifat, komisionet që duhen paguar dhe format e tjera të pagesës.

Neni 13
Studimi paraprak i tregut

1. Përpara se të nisë një procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor mund të studiojë tregun, me qëllim që të përgatisë prokurimin, të përditësojë të dhënat që ka përdorur për hartimin e buxhetit dhe regjistrave të parashikimit, si dhe të informojë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim.

2. Studimi i tregut ka për qëllim përllogaritjen e një vlere reale të kontratës dhe të shmangë dështimin e procedurës për vlera që nuk përputhen me vlerat reale të tregut.

3. Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit ngarkon me detyrë për studimin e tregut, një ose disa persona, që mund të jenë një grup pune i ngritur për këtë qëllim çdo fillim viti, ose rast pas rasti.

4. Për studimin e tregut, autoriteti/enti kontraktor, mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg me shkrim ose verbalisht. Në rastin e konsultimit verbalisht, grupi i ngritur për këtë qëllim, harton një procesverbal me këto të dhëna. Këto këshilla mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës dhe cenojnë parimet e mosdiskriminimit dhe transparencës.

   Autoriteti/enti kontraktor, duhet të kujdeset që konsultimi të jetë sa më gjithpërfshirës dhe të shmangë dhënien e çdo informacioni preferencial, që mund të favorizojë operatorë të caktuar në përgatitjen e ofertës për procedurën e prokurimit.

5. Në çdo rast, duhet të shmanget rreptësisht çdo konflikt interesi, apo edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik. Zyrtarët e përfshirë në studimin e tregut duhet të plotësojnë deklaratën për situatën e konfliktit të interesit.

KREU V
DOKUMENTET E TENDERIT

SEKSIONI I
Dokumentet standarde të tenderit

Neni 14
Miratimi dhe përdorimi i dokumenteve standarde të tenderit

1. APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, të LPP-së, dhe çdo tip kontrate.

2. Autoriteti/enti kontraktor përdor dokumentet standarde të tenderit sipas përcaktimit në këto rregulla dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike ose kundrejt pagesës, në procedurat që zhvillohen në formë shkresore. Në çdo rast, pagesa e kërkuar nga autoriteti ose enti kontraktor, për dokumentet e tenderit, nuk duhet të tejkalojë shpenzimet për kopjimin e këtyre dokumenteve. Emrat dhe numri i operatorëve ekonomikë, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo kqyrjen e tij, duhet të mbahen sekret.

3. Autoriteti/enti kontraktor, nëpërmjet mjeteve elektronike, duhet të ofrojë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë të dokumenteve të tenderit, duke nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose ftesës për shprehje interesi.

   Kur, për arsye objektive dhe të argumentuara, autoriteti/enti kontraktor nuk mund të ofrojë akses të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë pa pagesë, nëpërmjet mjeteve elektronike, të disa prej dokumenteve të tenderit, duhet të përcaktojë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, se këto dokumente tenderi do t'u vendosen në dispozicion nëpërmjet mjeteve të ndryshme nga ato elektronike dhe procedurën e qartë për paisjen e operatorëve ekonomikë me këto dokumente. Afati për pritjen e ofertave në këtë rast, zgjatet sipas parashikimit në pikën 3, të nenit 74, të LPP-së.

Neni 15
Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit

1. Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.

2. Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:

   - njoftimin paraprak të informacionit/ njoftimin periodik të informacionit
   - njoftimin e kontratës;
   - ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);
   - udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;
   - kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes;
   - formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;
   - deklaratën e konfliktit të interesit;
   - deklaratën e informacionit konfidencial;
   - formularin e ofertës ekonomike;
   - sigurimin e ofertës;
   - njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
   - njoftimin e fituesit;
   - formularin e ankesës;
   - modelin e marrëveshjes kuadër;
   - njoftim për lidhjen e marrëveshjes kuadër;
   - model kontrate, ku përfshihen kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të propozuara të kontratës;
   - sigurimin e kontratës;
   - njoftimin e lidhjes së kontratës;
   - njoftimin e anulimit të procedurës.

3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:

   a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:

   - projektin dhe specifikimet;
   - preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos/ mënyrën e paraqitjes së ofertës;
   - grafikun e zbatimit;
   - kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

   b) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:

   - specifikimet teknike;
   - grafikun e lëvrimit;

- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:

- termat e referencës;
- grafikun e ekzekutimit;
- kërkesat për personelin kryesor;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

SEKSIONI II
INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Neni 16
Njoftimi paraprak i informacionit

1. Pasi autoriteti kontraktor ka bërë planifikimin e procedurave të prokurimit, për procedura të veçanta mund të shpallë një njoftim paraprak të informacionit. Njoftimi paraprak i informacionit shpallet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Në Buletinin e Njoftimeve Publike, njoftimet paraprake të informacionit qëndrojnë të publikuara:

   a) deri në shpalljen e njoftimit të kontratës për procedurën respektive;
   b) në rastet e njoftimeve që synojnë të krijojnë një sistem dinamik blerjeje, për periudhën e vlefshmërisë së sistemit dinamik të blerjes.

3. Njoftimi paraprak i informacionit përmban të paktën:

   - emrin dhe adresën e autoritetit kontraktor;
   - emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës të prokurimit;
   - objektin e kontratës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV);
   - llojin e procedurës së prokurimit;
   - tipin e kontratës;
   - vlerën limit të përllogaritur të kontratës/vlerën limit të përllogaritur për këtë objekt në parashikimet buxhetore të autoritetit kontraktor;
   - kohëzgjatjen e përafërt të kontratës;
   - një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet nëse përdoren;
   - llojin e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti;
   - kohën e përafërt të zhvillimit të procedurës së prokurimit;
   - informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Për procedurat e kufizuara dhe procedurat konkurruese me negociim, kur autoriteti kontraktor përdor njoftimin paraprak të informacionit si një ftesë për ofertë, sipas parashikimeve në LPP-së, ky njoftim, veç informacionit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, përmban edhe:

   - një përshkrim specifik për furnizimet, punët ose shërbimet që do të jenë objekt i kontratës;
   - përcaktimin se kontrata do të jepet nëpërmjet procedurës së kufizuar ose procedurës konkurruese me negociim, pa shpallje të mëtejshme të një ftese për ofertë dhe fton operatorët ekonomikë të interesuar për të shprehur interesin e tyre.

5. Autoriteti kontraktor mund të klasifikojë një njoftim, si njoftim paraprak të informacionit, kur ai ka përmbajtjen e përcaktuar në LPP dhe në këtë nen, dhe është publikuar jo më larg se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga momenti i publikimit të njoftimit të kontratës deri 35 (tridhjetë e pesë) ditë para publikimit të saj.

6. Për njoftimet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 57, të LPP-së, dhe në pikën 3, të këtij neni, afati i përcaktuar në pikën 5, përllogaritet nga data kur dërgohet ftesa për ofertë.

7. Nga afati i përcaktuar në pikën 5, bëjnë përjashtim, njoftimet për kontratat për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike, ku njoftimi paraprak i informacionit mund të mbulojë një periudhë më të gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Neni 17
Njoftimi periodik i informacionit

1. Enti kontraktor, pasi ka bërë planifikimin e procedurave të prokurimit, për procedura të veçanta mund të shpallë një njoftim periodik të informacionit. Njoftimi periodik i informacionit shpallet në sistemin e prokurimit elektronik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Në Buletinin e Njoftimeve Publike, njoftimet periodike të informacionit qëndrojnë të publikuara:

   a) deri në shpalljen e njoftimit të kontratës për procedurën respektive;
   b) në rastet e njoftimeve që synojnë të krijojnë një sistem kualifikimi, për periudhën e vlefshmërisë së sistemit të kualifikimit.

3. Njoftimi periodik i informacionit përmban të paktën:

- emrin dhe adresën e entit kontraktor;
- emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës të prokurimit;
- objektin e kontratës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV);
- llojin e procedurës së prokurimit;
- tipin e kontratës;
- vlerën limit të përllogaritur të kontratës; /vlerën limit të përllogaritur për këtë objekt në parashikimet buxhetore të autoritetit kontraktor;
- kohëzgjatjen e përafërt të kontratës;
- një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet nëse përdoren;
- llojin e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti;
- kohën e përafërt të zhvillimit të procedurës së prokurimit;
- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga enti kontraktor.

4. Enti kontraktor mund të klasifikojë një njoftim si njoftim periodik të kontratës, kur ai ka përmbajtjen e përcaktuar në LPP dhe në këtë nen dhe është publikuar jo më larg se 12 muaj nga momenti i publikimit të njoftimit të kontratës deri 35 (tridhjetë e pesë) ditë para publikimit të saj.

5. Njoftimi periodik i informacionit mund të përdoret si mjet për të bërë ftesën për konkurrim në procedurën e hapur, të kufizuar, negociim me shpallje paraprake të njoftimit, partneritetit për inovacion dhe dialogun konkurrues të kontratave sektoriale, dhe në këtë rast, afati për pritjen e ofertave mund të shkurtohet, por nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

Neni 18
Njoftimi për praninë e një sistemi kualifikimi

1. Enti kontraktor, në prokurimin e kontratave sektoriale, mund të zgjedhë të përdorë sistemet e kualifikimit. Njoftimi në këtë rast është i detyrueshëm dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së sistemit.

2. Njoftimi për krijimin e një sistemi kualifikimi përmban të paktën:

- emrin dhe adresën e entit kontraktor;
- emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës të prokurimit;
- qëllimi i sistemit të kualifikimit;
- objektin e kontratës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të prokurimit (CPV);
- llojin e kontratës ose kategori sipas llojit të kontratës, kur ka një ndarje të tillë;

- llojin e procedurës së prokurimit që enti kontraktor planifikon të përdorë për dhënien e kontratave;
- periudhën e vlefshmërisë së sistemit të kualifikimit;
- kriteret për kualifikim të operatorëve ekonomikë;
- kriteret për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga sistemi i kualifikimit;
- kriteret për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë të tjerë dhe përditësimin periodik të kualifikimeve;
- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga enti kontraktor.

3. Enti kontraktor njofton për çdo ndryshim gjatë periudhës së vlefshmërisë së një sistemi kualifikimi, në të njëjtën mënyrë sikurse përcaktohet në këtë nen.

Neni 19
Njoftimi i kontratës

1. Njoftimi i kontratës përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që i jep mundësi operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë ose jo në procedurat e prokurimit publik.

2. Njoftimi i kontratës përfshin të paktën informacionin e mëposhtëm:

- emrin dhe adresën autoritetit/entit kontraktor;
- emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës për procedurën;
- objektin e procedurës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV);
- referencën e njoftimit;
- llojin e procedurës së prokurimit;
- tipin e kontratës;
- vlerën limit të përllogaritur të kontratës dhe burimin e financimit;
- vlerën e sigurimit të ofertës;
- kohëzgjatjen e kontratës;
- një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet nëse përdoren;
- kriteret e shpalljes së fituesit;
- kushtet e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti;
- vendin, mënyrat dhe tarifën për tërheqjen e dokumenteve të tenderit, nëse kërkohet;
- vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre;
- gjuhën /gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;
- informacion nëse është përdorur njoftim paraprak/periodik i informacionit;
- informacion nëse lejohet nënkontraktim dhe masa/përqindja e lejuar;
- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti/enti kontraktor.

3. Në rastet e procedurave të prokurimit me faza, informacioni i dhënë në njoftimin e kontratës duhet t'i referohet fazës së parë të kualifikimit të procedurës.

4. Në rastet e aplikimit të mundësisë së reduktimit të numrit të operatorëve ekonomikë, në procedurat e prokurimit me faza, ky informacion duhet të bëhet i ditur në njoftimin e kontratës.

5. Në rastet e procedurave të prokurimit të rishpallura pas anulimit, njoftimi i kontratës duhet të përmbajë të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar, si numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik, objekti dhe fondi limit.

Neni 20
Njoftimet e konkursit të projektimit

1. Autoriteti/enti kontraktor që synon të zhvillojë një konkurs projektimi, njofton qëllimin e tij nëpërmjet njoftimit të konkursit. Njoftimi i konkursit përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që i jep mundësi operatorëve ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë ose jo në konkurs. Informacioni i dhënë në njoftimin e kontratës duhet t'i referohet fazës së parë të kualifikimit të procedurës.

2. Njoftimi i konkursit të projektimit përfshin të paktën informacionin e mëposhtëm:

   - emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;
   - emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës për procedurën;
   - objektin e kontratës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV);
   - referencën e njoftimit;
   - numrin dhe vlerën e çmimeve;
   - vlerën e përafërt për hartimin e projektit të zbatimit, nëse është rasti;[12]
   - lloji i konkursit të projektimit (me ose pa reduktim të numrit të operatorëve);
   - procedurën e prokurimit që do të ndiqet Në rast se në vijim synohet lidhja e një kontrate shërbimi, sipas përcaktimit në nenin 47 të LPP-së;
   - në rastin e një konkursi projektimi pa reduktim numri të operatorëve, afatin kohor për dorëzimin e projekteve;
   - në rastin e një konkursi projektimi me reduktim numri të operatorëve ekonomikë, sipas parashikimit në pikën 3 të nenit 106 të LPP-së, njoftimi duhet të përmbajë edhe numrin e parashikuar të pjesëmarrësve, emrat e

[12] Shtuar me VKM 498/2024

pjesëmarrësve të përzgjedhur, nëse ka, kriteret e qarta për përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe afatin kohor për kërkesat për pjesëmarrje.
- një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet nëse përdoren;
- kohëzgjatjen e kontratës;
- kriteret e kualifikimit;
- vendin, mënyrat dhe tarifën për tërheqjen e dokumenteve të tenderit, nëse kërkohet;
- vendin, datën dhe orën për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe hapjen e tyre;
- gjuhën /gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;
- informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti/enti kontraktor.

3. Në rastet e konkursit të projektimit të rishpallur pas anulimit, njoftimi mbi ndryshimet dhe informacionet shtesë në një konkurs projektimi, duhet të përmbajë të njëjtat të dhëna që parashikohen në nenin 19 të këtyre rregullave.

   Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor respekton rregulla të njëjta si për publikimin e njoftimit të kontratës dhe rregullat e përcaktuara në nenin 75 të LPP-së për shtyrjen e afateve për pritjen e ofertave, kur është rasti.

4. Njoftimi për rezultatet e konkursit publikohet sipas përcaktimit në pikën 3, të nenit 105, të LPP-së, dhe përmban:

   - emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;
   - emrin dhe kontaktet e personit/ave për përgjegjës për prokurimin;
   - objektin e konkursit;
   - një përshkrim të shkurtër të kontratës;
   - referencën e njoftimit;
   - numrin dhe vlerën e çmimeve;
   - llojin e konkursit të projektimit (me ose pa reduktim të numrit të operatorëve ekonomikë);
   - kriteret që janë zbatuar për vlerësimin e projekteve;
   - numrin e pjesëmarrësve;
   - datën e vendimit të jurisë;
   - emrat e fituesve të konkursit dhe identifikimi i tyre (NIPT, adresë etj.);
   - datën e dërgimit të njoftimit;
   - informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti/enti kontraktor.

5. Kur autoriteti/enti kontraktor gjykon se është në kushtet e parashikuara në pikën 4 të nenit 105 të LPP-së, duhet të argumentojë dhe dokumentojë arsyet e mospublikimit të informacionit mbi rezultatet e konkursit të projektimit.

Neni 21

Ftesa për ofertë

1. Ftesa për ofertë u dërgohet vetëm kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë të kualifikimit në procedurën e prokurimit me faza. Ftesa përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që t'u mundësojë kandidatëve të përzgjedhur të dorëzojnë ofertat e tyre.

2. Ftesa për ofertë përfshin të paktën informacionin e mëposhtëm:

   - një referencë për njoftimin e publikuar të kontratës;
   - kriteret e shpalljes së fituesit;
   - kushtet e marrëveshjes kuadër, nëse është rasti;
   - vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave dhe hapjen e tyre;
   - gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;
   - informacione të mëtejshme që autoriteti/enti kontraktor i vlerëson të nevojshme.

Neni 22
Njoftimi vullnetar i transparencës për procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

1. Pavarësisht se, publikimi i njoftimit të kontratës nuk është i detyrueshëm në rastin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor, mund të vendosë të publikojë një njoftim për të rritur transparencën dhe konkurrueshmërinë në procedurë.

2. Ky njoftim publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.

3. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimin e kontratës, me të njëjtën përmbajtje sipas përcaktimit në nenin 19 të këtyre rregullave, si dhe në dokumentet përkatëse të tenderit.

Neni 23
Njoftimi i modifikimit të kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj

1. Kur autoriteti/enti kontraktor modifikon një kontratë ose marrëveshje kuadër të lidhur në përfundim të procedurave që parashikon LPP dhe këto rregulla, duhet të pasqyrojë modifikimin, në sistemin e prokurimit elektronik[13].

[13] Ndryshuar me VKM 498/2024

2. Modifikimi i kontratave apo marrëveshjeve kuadër bëhet vetëm në rastet e parashikuara në nenin 127 të LPP-së, kur autoriteti/enti kontraktor mund të argumentojë se ndodhet në njërin nga këto raste.

3. Njoftimi i modifikimit të kontratës apo marrëveshjes kuadër përmban të paktën:

   - emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;
   - emrin dhe kontaktet e personit/ave përgjegjës për procedurën;
   - objektin e procedurës dhe kodin përkatës në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit (CPV);
   - llojin e procedurës;
   - tipin e kontratës;
   - referencën e njoftimit;
   - situatën e parashikuar në nenin 127 të LPP-së, në të cilën ndodhet autoriteti/ enti kontraktor, për modifikimin e kontratës apo marrëveshjes kuadër dhe argumentet për përdorimin e saj;
   - një përshkrim të shkurtër të modifikimit të kontratës apo marrëveshjes kuadër. Përfshihen këtu, natyra dhe volumi i punëve, natyra dhe sasia ose vlera e mallrave, natyra dhe volumi i shërbimeve;
   - vlerën e kontratës së nënshkruar dhe vlerën e ndryshuar (nëse ka);
   - kohëzgjatjen e kontratës apo marrëveshjes kuadër dhe afatin e ri (nëse ka);
   - emrin dhe adresën, duke përfshirë kontaktet dhe identifikimin e operatorit/rëve operatorëve ekonomikë të rinj (kur është rasti);
   - datën e nënshkrimit të modifikimit;
   - burimin e financimit;
   - informacione të tjera të vlerësuara të dobishme nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Autoriteti/enti kontraktor në rast se, ka modifikuar marrëveshjen kuadër apo kontratën, sipas pikës 1, shkronjat "b" dhe "c", të nenit 127 të LPP, duhet të dërgojë për publikim një njoftim për ndryshimin e marrëveshjes kuadër apo kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj, në Buletinin e Njoftimeve Publik, brenda pesë ditëve, nga data në të cilën ka bërë modifikimin e kontratës fillestare[14].

Neni 24
Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët

1. Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës, nga pjesëmarrësit bazuar në dokumentet standarde të tenderit.

[14] Ndryshuar me VKM 498/2024

2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Një ofertë është e kualifikueshme edhe nëse një pjesë e dokumentacionit të saj mund të jetë në gjuhën shqipe dhe një pjesë në gjuhën angleze.[15]

   Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

3. Në rastin e procedurave mbi kufijtë e lartë monetarë, autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimet e procedurave të prokurimit, në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Publikimet edhe në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, sipas përcaktimeve të nenit 56 të LPP-së, bëhet kur ky detyrim vjen nga angazhimi i shtetit shqiptar në raport me strukturat e Bashkimit Evropian.

4. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, autoriteti/ enti kontraktor konverton[16] vlerën e ofertës së paraqitur në një monedhë e huaj[17], të përzgjedhur prej tij në dokumentet e tenderit, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës.

5. Në udhëzime duhet të përcaktohet që, nëse autoriteti/enti kontraktor vendos të organizojë një vizitë në terren/objekt, atëherë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në tender duhet të kenë mundësi të barabarta për të vëzhguar terrenin e punës/ekzekutimit. Gjithashtu, autoriteti/enti kontraktor mund të organizojë një konferencë paraprake (edhe në rastin e mallrave), ku të gjithë kandidatët të mund të kërkojnë sqarime për paqartësitë që u lindin gjatë përgatitjes së dokumenteve.

   Kërkesat për sqarime duhet të paraqiten me shkrim dhe përgjigjet përkatëse të autoritetit/entit kontraktor duhet t'u dërgohen, pa përjashtim, të gjithë operatorëve ekonomikë që kanë kërkuar dokumentet e tenderit.

---

[15] Ndryshuar me VKM 498/2024

[16] Ndryshuar me VKM 498/2024

[17] Ndryshuar me VKM 498/2024

Në rastin e procedurave të prokurimit me mjete elektronike, kërkesat për sqarim bëhen sipas udhëzimeve të APP-së.

Çdo ndryshim në dokumentet e tenderit duhet t'i bëhet i njohur çdo operatori ekonomik të interesuar, në përputhje me nenin 75, të LPP-së, dhe me këto rregulla.

6. Gjatë përgatitjes së ofertave, kandidatët ose ofertuesit duhet të përfshijnë të gjitha detyrimet fiskale, që janë në fuqi deri në 28 (njëzet e tetë) ditë para hapjes së ofertave, me përjashtim të TVSH-së, e cila, nëse është e aplikueshme, do të llogaritet mbi vlerën e ofertës.

7. Ofertat ekonomike të dhëna nga ofertuesi duhet të jenë të fiksuara përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t'i nënshtrohen asnjë ndryshimi.

   Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

   Oferta e paraqitur me çmim të ndryshueshëm do të refuzohet nga autoriteti/enti kontraktor, si e papranueshme.

8. Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 (pesë) ditë përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshmërinë e ofertave, autoriteti/enti kontraktor mund t'i kërkojë ofertuesit, me shkrim, të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton autoritetin/entin kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së autoritetit/entit kontraktor, lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë autoriteti/enti kontraktor do të refuzojë ofertën.

   Nëse autoriteti/enti kontraktor nuk ka bërë një kërkesë me shkrim për operatorin ekonomik që të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatori ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë mungesë.

9. Udhëzimet japin informacion edhe për procedurën e rishikimit dhe të dorëzimit të ankesave.

Neni 25[18]
Kriteret e kualifikimit

1. Kriteret e përgjithshme të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të këtij ligji, përsa kërkohet nga autoriteti/enti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u plotësuar nga çdo operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.
   Këto kritere synojnë sigurimin e ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës.

2. Në procedurat e prokurimit me faza, operatori ekonomik, në fazën e parë, duhet të plotësojë kriteret për kualifikim, të parashikuara në nenin 76, si dhe nenin 77, të LPP, për sa kërkohet nga autoriteti/enti kontraktor për t'u kualifikuar në fazën tjetër.

3. Autoritetet/entet kontraktore janë të detyruara që në hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-së, si edhe në hartimin e specifikimeve teknike, sipas parashikimeve të nenit 36, të LPP-së, të zbatojnë, përveç këtyre rregullave për prokurimin publik, edhe detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

   a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efiçencën e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
   b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
   c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

[18] Ndryshuar me VKM 498/2024

Neni 26
Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

   a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
   b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
   c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
   ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi[19];
   d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
   dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve [20]të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
   e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
   ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
   f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

[19] Ndryshuar me VKM 498/2024

[20] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;

l) [21]operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll)[22] operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të

[21] Shtuar me VKM 498/2024

[22] Shtuar me VKM 498/2024

këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuara me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij[23].

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t´i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Neni 27
Deklarimi i konfliktit të interesit

1. Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë gjendjen mbi konfliktin e interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

[23] Ndryshuar me VKM 498/2024

Ky deklarim garanton autoritetin/entin kontraktor që ofertuesit/kandidatët nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

2. Deklarimi i konfliktit të interesit përmban të dhënat personale të ofertuesit/kandidatit dhe grupet e personave që konsiderohen si persona në konflikt interesi, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 28
Deklarimi i informacionit konfidencial

1. Nëpërmjet listës së informacionit konfidencial, kandidati/ofertuesi deklaron informacionin ose dokumentet që kërkon të mbahet konfidencial dhe argumentet për këtë. Një operator ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund të mos bëjë publik ose shpërndajë informacione të caktuara, përfshirë sekretet teknike ose tregtare dhe veçoritë konfidenciale të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje.

2. Nëse operatori ekonomik e ka klasifikuar informacionin si konfidencial, ai është i detyruar të cilësojë bazën juridike, mbi të cilën ky informacion është klasifikuar si i tillë.

3. Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 29
Oferta ekonomike

1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.

2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

Neni 30
Sigurimi i ofertës

1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.

Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së.

Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari.

3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit[24]. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.

4. Lëshuesi i sigurimit të ofertës duhet:
   a) të mos vendosë asnjë kusht për pagimin;
   b) të paguajë shumën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës zyrtare të autoritetit/entit kontraktor.

5. Autoriteti/enti kontraktor duhet t'ua kthejë apo t'ua lirojë ofertuesve sigurimin e ofertës jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga:

   a) data kur ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës, për të gjithë ofertuesit, përveç ofertuesit/ve fitues;
   b) data kur është lidhur kontrata, për ofertuesin/ët fitues;
   c) data kur janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues, për të gjithë ofertuesit.

6. Autoriteti/enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës, në rast të:

   a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave;
   b) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese;
   c) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit. Në rast se kontrata nuk nënshkruhet nga ofertuesi fitues për ndonjë situatë të forcës madhore, autoriteti kontraktor nuk mban sigurimin e ofertës.

[24] Shtuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

7. Rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik, sipas shkronjave "b" dhe "c", të pikës 6, të këtij neni[25], të këtij neni, raportohen nga autoriteti/enti kontraktor pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, me qëllim veprimin nga kjo e fundit, sipas parashikimeve të nenit 78, të LPP-së.

8. Në rastin kur, është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese "oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim" dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe asaj në vend të dytë, është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

   Me të njëjtin rregull, mund të kalohet tek ofertat e renditura në vijim në rast se diferenca e ofertës së radhës me ofertën fituese fillestare, të mos jetë më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës, të renditur para saj.

Neni 31
Njoftimi i skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve

Ky njoftim përmban të gjitha arsyet e skualifikimit të një ofertuesi apo kandidati në një procedurë prokurimi.

Neni 32
Njoftimi i fituesit

1. Jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik, njoftimin e fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit. Në rastin e procedurave të prokurimit, që zhvillohen ose përfundohen në formë shkresore, ky njoftim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike[26].

2. Me publikimin e njoftimit të fituesit sipas pikës 1 të këtij neni[27], operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109, të LPP-së, dhe këtyre rregullave.

3. Njoftimi i fituesit për kontratën sipas pikës 1, të këtij neni,[28] duhet të përmbajë të paktën:

[25] Ndryshuar me VKM 498/2024
[26] Ndryshuar me VKM 498/2024
[27] Ndryshuar me VKM 498/2024
[28] Shtuar sipas VKM 498/2024

- emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;
- referencën e procedurës;
- objektin e prokurimit (përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve);
- emrin, NIPT-in dhe adresën e ofertuesit/ve (në rast të bashkimit të operatorëve), të shpallur fitues;
- kohëzgjatjen e kontratës dhe çmimin/vlerën e ofertës fituese;
- emrat, NIPT-et dhe çmimet/vlerën e ofertuesve të tjerë;
- emrat, NIPT-et e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit.

4. Njoftimi i fituesit për marrëveshjen kuadër sipas pikës 1, të këtij neni,[29] duhet të përmbajë të paktën:

- emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;
- referencën e procedurës;
- emrin, NIPT-in dhe adresën e ofertuesit/ofertuesve të shpallur fitues;
- objektin e prokurimit (përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve);
- kohëzgjatjen e marrëveshjes kuadër dhe çmimin/vlerën e ofertës/ave fituese;
- emrat, NIPT-et dhe çmimet/vlerën e ofertuesve të tjerë;
- emrat, NIPT-et e ofertuesve të skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit.

5. Pas përfundimit të afateve të ankimit ose procesit të ankimit, nëse ka një të tillë, autoriteti/enti kontraktor harton njoftimin e fituesit të procedurës me të cilin njofton operatorin ekonomik fitues për vijimin e hapave të mëtejshëm drejt nënshkrimit të kontratës apo marrëveshjes kuadër. Këto njoftime përmbajnë informacionin e përcaktuar në pikat 3 dhe 4, të këtij neni[30].

Neni 33
Formulari i ankesës

Kundër veprimeve ose mosveprimeve të autoritetit/entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar mund të bëjnë ankesë pranë këtij të fundit dhe Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet një formulari standard, i cili përmban udhëzimet e nevojshme për plotësimin dhe nënshkrimin e tij.

Neni 34
Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës

[29] Shtuar sipas VKM 498/2024
[30] Ndryshuar sipas VKM 498/2024

1. Kushtet e përgjithshme të kontratës përcaktojnë kushtet e zbatueshme sipas tipit të kontratave për mallra, punë ose shërbime.

2. Kushtet e veçanta të kontratës përkufizojnë tërësinë e punëve që do të kryhen, të gjitha mallrat apo shërbimet që do të furnizohen, të drejtat dhe detyrimet ndërmjet autoritetit/entit kontraktor dhe kontraktorit, si dhe detyrimet për përmbushjen, mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratës.

Neni 35
Marrëveshja kuadër

Marrëveshja kuadër përmban formën e marrëveshjes, objektin, si dhe termat e kushtet e marrëveshjes.

Neni 36
Sigurimi i kontratës

1. Sigurimi i kontratës garanton autoritetin/entin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit/entit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj. Në çdo rast autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor[31]. Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, të licencuara nga autoritetet kompetente[32]. Ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se afati për përfundimin e garancisë së punëve/shërbimit/mallrave, kur një gjë e tillë parashikohet në kontratë.

2. Gjatë ekzekutimit, nëse janë parashikuar pagesa periodike sipas grafikut të zbatimit të kontratës, kontraktori mund të kërkojë reduktimin e përqindjes së vlerës së sigurimit në mënyrë përpjesëtimore. Në çdo rast, të paktën 25% e vlerës korresponduese të sigurimit të kontratës, do të mbetet si garanci deri në përfundim të afatit të sigurimit të kontratës.

Neni 37
Njoftimi i lidhjes së kontratës

1. Autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim njoftimin e lidhjes së kontratës brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi i saj.

2. Njoftimi i lidhjes së kontratës duhet të përmbajë të paktën:

   - emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;

[31] Shtuar me VKM 498/2024
[32] Ndryshuar me VKM 498/2024

- numrin e referencës së procedurës/kontratës;
- objektin e kontratës (përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve);
- emrin, NIPT-in dhe adresën e ofertuesit/ofertuesve (në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë), me të cilin është nënshkruar kontrata;
- çmimin dhe kohëzgjatjen e kontratës;
- të dhëna të tjera nga autoriteti/enti kontraktor.

3. Autoriteti kontraktor duhet të dërgojë për publikim kontratën fituese për çdo kontratë të lidhur nga një marrëveshje kuadër.

Neni 38
Njoftimi i anulimit

1. Jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja e vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit, autoriteti ose enti kontraktor harton njoftimin e anulimit, i cili dërgohet për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe u komunikohet të gjithë kandidatëve ose ofertuesve. Në rastin e procedurave të prokurimit, që zhvillohen ose përfundohen në formë shkresore, ky njoftim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike.
Me publikimin e këtij njoftimi, operatorëve ekonomikë iu lind e drejta e ankimit, sipas parashikimeve në LPP dhe në këto rregulla.[33]

2. Njoftimi i anulimit sipas parashikimeve të pikës 1 të këij neni[34] duhet të përmbajë të paktën:

- emrin dhe adresën e autoritetit/entit kontraktor;
- numrin e referencës së procedurës;
- objektin e procedurës së prokurimit (përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve);
- emrin, NIPT-et dhe adresat e ofertuesve;
- arsyet dhe bazën ligjore të anulimit të procedurës, sipas përcaktimeve të nenit 98, të LPP-së.

3. Autoriteti/enti kontraktor vijon me publikimin e vendimit përfundimtar për anulimin e procedurës së prokurimit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin, duke e publikuar njoftimin në të njëjtën mënyrë siç publikon njoftimin e kontratës.[35]

SEKSIONI III

[33] Ndryshuar me VKM 498/2024
[34] Shtuar me VKM 498/2024
[35] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

KËRKESA TË VEÇANTA SIPAS TIPEVE TË KONTRATAVE

Neni 39
Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike

1. Punët publike mund të prokurohen:

   a) me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuara në projektpreventiv mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar.

      Kur punët prokurohen me anë të punimeve me matje, vëllimi i punëve jepet me hollësi dhe përmban të gjitha çmimet dhe përqindjet që autoriteti/enti kontraktor i vlerëson të nevojshme (si për shembull: fondi rezervë, të ardhurat minimale, shpenzimet minimale).

   b) me kontratë me çelësa në dorë:

      i. Ku vëllimi i punëve i parashikuar në projektpreventiv, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.

         Në këtë rast, kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

      ii. Kur autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv, por ka vetëm një projektide, apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron.

         Në këtë rast, autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori hartimin e projektpreventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij nga autoriteti kontraktor.

   Autoriteti/enti kontraktor duhet të kërkojë nga ofertuesit disponimin e kapaciteteve teknike për realizimin e secilës fazë të sipërcituar: për hartimin e projektit, si dhe për realizimin e tij, duke lejuar edhe mundësinë që projektimi mund të nënkontraktohet, apo që ofertuesi (zbatuesi i punimeve) të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit dhe që plotësojnë të gjitha kriteret e hartuara nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë qëllim.

Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, sipas projektpreventivit të miratuar paraprakisht nga autoriteti kontraktor, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

2. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

3. Autoriteti/enti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon me grafik, fazat dhe afatet e realizimit të punëve.

4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

   a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
   b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

   Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

   Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

   Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet

tatimore[36] dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

   a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
   b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose
   c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë *CV*-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
   ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
   d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

   a) Operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
   b) Operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi.
   c) Operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.
   ç) Operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

[36] Shtuar me VKM 498/2024

Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me vlerën totale të përllogaritur të kontratës/ave.

Neni 40
Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave

1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

   Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore[37], ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

   Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

[37] Shtuar me VKM 498/2024

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

   a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
   b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
   c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
   ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

   a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.[38] Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

   b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
   c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

7. Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

[38] Ndryshuar me VKM 498/2024

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi.
c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.
ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

9. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përllogaritur.

Neni 41
Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

   Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe

faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore[39] ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimi.[40]

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme [41]stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në

[39] Shtuar me VKM 498/2024
[40] Ndryshuar me VKM 498/2024
[41] Ndryshuar me VKM 545/2024

fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi.
c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.
ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përllogaritur.

Neni 42
Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

   Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet

në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

6. Kur zbatimi i kritereve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kritere duhet të jenë në përputhje me LPP-në dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.

7. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

Neni 43
Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare[42].

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

   a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit[43], në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
   b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;
   c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë

41.Riformuluar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021
[43] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme[44].

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit[45]. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.[46]

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Neni 44
Kërkesat e cilësisë

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës,

[44] Ndryshuar me VKM 498/2024
[45] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021
[46] Shtuar me VKM 498/2024

mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

3. Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

4. Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkojnë një certifikatë, ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.

5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 45
Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date[47];
b) elementet fiskale;
c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës[48].

APP publikon çmimet e bursës së dërguar për publikim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave[49].

3. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.

4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në:

   a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose
   b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose
   c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

   a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

[47] Ndryshuar me VKM 498/2024

[48] Shtuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021
[49] Shtuar me VKM 498/2024

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

[50]Në rastin kur, oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të kostos, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm.
Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

Po = Pk1+Pk2+Pk3+.....
Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar
Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

Pk1= Vmink1 x Pmaxk1/Ok1
Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet
Vmink1 ____Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet
Pmaxk1 _____Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

[50] Ndryshuar me VKM 498/2024

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

Pk1= Ok1 x Pmaxk1 /Vmax k1
Vmaxk1_____Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet
Pmaxk1 _____Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
Ok1 _____Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

9.[51] Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë "oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto", ku çmimi do të ketë jo më pak se 20 pikë dhe propozimi teknik jo më pak se 80 pikë. Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 dhe më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse.

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik.
Formula e llogaritjes është: Oferta më e mirë = X + Y
Pesha për Propozimin Teknik: X = (pikët e propozimit teknik x 0.8)
Pesha për Propozimin Ekonomik: Y = (pikët e propozimit ekonomik x 0.2)

a) Për kriteret, që mund të përdoren për propozimet teknike, autoriteti ose enti kontraktor mund të marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

i. Përvoja për punë të ngjashme të konsulentit;
ii. cilësinë e metodologjisë së propozuar;
iii. kualifikimet e stafit kryesor të propozuar.

Nënkriteret e kritereve të vlerësimit teknik do të përcaktohen në dokumentet standarde të tenderit për shërbimet.

b) Vlerësimi i propozimeve ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe- Pikët për propozimin ekonomik
Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar
Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

Pe = 100 x Çu / Ç (çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik).

KREU VI

[51] Shtuar me VKM 498/2024

LLOJET DHE PËRZGJEDHJA E PROCEDURËS

Neni 46
Llojet e procedurave të prokurimit

1. Në përzgjedhjen e kontratave publike, autoriteti/enti kontraktor zbaton konkurset e projektimit dhe procedurat standarde të prokurimit publik, të përcaktuara në nenin 41 të LPP-së.

2. Llojet e procedurave që duhen përdorur në përzgjedhjen e kontratave të prokurimit publik, janë:

   a) procedurë e hapur;
   b) procedurë e kufizuar;
   c) partneritet për inovacion;
   ç) dialogu konkurrues;
   d) [52];
   dh) procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
   e) procedurë konkurruese me negociim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik;
   ë) procedurë me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave sektoriale;
   f) procedurë e hapur e thjeshtuar;
   g) prokurim me vlerë të vogël.

Neni 47
Procedura e hapur

1. Procedura e hapur, sipas nenit 42, të LPP-së, është procedura e prokurimit me një fazë, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, me një vlerë mbi kufirin e ulët monetar.

2. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me nenin 56 të LPP-së dhe me këto rregulla.

3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 42, të LPP-së. Autoriteti/enti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

[52] Shfuqizuar me VKM 498/2024

4. Pas mbarimit të afatit për paraqitjen e ofertave, të përcaktuar në njoftimin e kontratës, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 42 të LPP-së, autoriteti/ enti kontraktor hap ofertat, vlerëson dokumentacionin e ofertuesve, në bazë të kritereve të përcaktuara në nenet 76 e 77, të LPP-së dhe këtyre rregullave dhe përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 87, të LPP-së.

Neni 48
Procedura e kufizuar

1. Procedura e kufizuar, sipas nenit 43, të LPP-së, është procedurë prokurimi me dy faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar.

2. [53]

3. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 77, të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.

4. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, njoftimi i kontratës shoqërohet me ftesën për shprehje interesi për procedurën e prokurimit. Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë.

   Nëse do të përdorë këtë mundësi, autoriteti/enti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e kontratës, ku duhet të përcaktojë dhe numrin minimal të kandidatëve që synon të ftojë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.

6. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 43, të LPP-së. Autoriteti/enti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

[53] Shfuqizuar me VKM 710 date 24.11.2021

7. Pas mbylljes së fazës së parë të kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, sipas parashikimit në nenin 110, të LPP-së, autoriteti/enti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur të dorëzojnë ofertat.

   Ofertat duhet të hartohen në bazë të specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, sipas afateve të përcaktuara në nenin 43, të LPP-së.

8. Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit të ofertuesve, në bazë të kritereve të përcaktuara në nenet 76 e 77, të LPP-së dhe këtyre rregullave, autoriteti/enti kontraktor përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 87 të LPP-së.

Neni 49
Procedurë konkurruese me negociim, në rastet e kontratave të sektorit klasik

1. Procedura konkurruese me negociim është procedura e prokurimit me faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet kontraktor, vetëm në rastet e parashikuara në nenin 51, të LPP-së.

2. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 77, të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.

3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 44, të LPP-së. Autoriteti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

4. Njoftimi i kontratës hartohet e publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla.

   Në çdo rast, njoftimi i kontratës shoqërohet me ftesën për shprehje interesi për procedurën e prokurimit. Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit.

5. Autoriteti mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë.

   Nëse do të përdorë këtë mundësi, autoriteti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e kontratës, ku duhet të përcaktojë dhe numrin minimal të kandidatëve që synon të ftojë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.

6. Pas mbylljes së fazës së parë të kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 110 të LPP-së, autoriteti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur të dorëzojnë ofertat tekniko-ekonomiko. Vetëm operatorët ekonomikë që janë ftuar nga autoriteti ose enti kontraktor mund të paraqesin ofertë fillestare, e cila shërben si bazë për negociimet vijuese.

7. Autoriteti kontraktor mund të negociojë individualisht me secilin nga ofertuesit e përzgjedhur deri në përcaktimin e ofertës fituese sipas parashikimit në LPP. Nuk ka një limit për numrin e fazave të njëpasnjëshme të negociimit, me kusht që autoriteti ose kontraktor të ketë publikuar informacionin ose të njoftojë rregullisht të gjithë ofertuesit për çdo fazë të negociimit sipas përcaktimit në nenin 44, të LPP-së.

8. Gjatë fazës së negociimit, autoriteti kontraktor, synon që ofertat të qartësohen, specifikohen dhe të përshtaten sipas kërkesës dhe nevojës së autoritetit kontraktor. Megjithatë, ky qartësim, specifikim, përshtatje ose informacion shtesë nuk duhet të përfshijë ndryshime në aspektet kryesore të ofertës, duke përfshirë nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës, të cilat mund të shtrembërojnë konkurrencën ose të kenë efekt diskriminues.

   Nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës nuk mund të ndryshohen në këtë fazë, pasi do të përfitohej një kontratë e ndryshme nga ajo, për të cilën është realizuar procedura e prokurimit.

9. Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit të ofertuesve, në bazë të kritereve të përcaktuara në nenet 76 e 77, të LPP-së, dhe këtyre rregullave, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 87, të LPP-së.

Neni 50
Dialogu konkurrues

1. Dialogu konkurrues, është procedura e prokurimit me tre faza, faza parakualifikuese, faza e dialogut dhe faza e paraqitjes së ofertës përfundimtare, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor vetëm në rastet e parashikuara në nenin 51, të LPP-së.

2. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 77 të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.

3. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe

me këto rregulla. Në çdo rast, njoftimi i kontratës shoqërohet me ftesën për shprehje interesi për procedurën e prokurimit.

4. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 45 të LPP-së. Autoriteti/enti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë.

   Nëse do të përdorë këtë mundësi, autoriteti/enti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e kontratës, ku duhet të përcaktojë dhe numrin minimal të kandidatëve që synon të ftojë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.

6. Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit, në përgjigje të njoftimit të kontratës apo edhe të njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi në rastin e kontratave sektoriale, duke dhënë informacionin që kërkohet, nga autoriteti ose enti kontraktor.

7. Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 110 të LPP-së, autoriteti/enti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur në fazën e dialogut. Vetëm operatorët ekonomikë që janë ftuar nga autoriteti ose enti kontraktor mund të marrin pjesë në këtë fazë.

8. Në këtë procedurë, kontrata jepet vetëm mbi bazën e kriterit të raportit çmim-cilësi, sipas parashikimeve në LPP.

9. Autoriteti/enti kontraktor fillon dialogun individual me pjesëmarrësit e përzgjedhur sipas parashikimeve në LPP, me qëllim identifikimin dhe përcaktimin e mjeteve që përshtaten më mirë me nevojat e tyre. Ata mund t'i diskutojnë të gjitha aspektet e prokurimit me pjesëmarrësit e përzgjedhur, gjatë këtij dialogu.

   Dialogu mund të zhvillohet në disa faza për të ulur numrin e zgjidhjeve që do të diskutohen në fazat pasardhëse të dialogut, kur autoriteti/enti kontraktor e ka njoftuar këtë mundësi në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë.

   Autoriteti/enti kontraktor nëse nuk bie dakord me të gjithë pjesëmarrësit për afatin ndërmjet fazave, cakton një afat të arsyeshëm dhe njofton pjesëmarrësit në kohë.

Autoriteti/enti kontraktor siguron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit, dhe në asnjë rast nuk jep informacione në mënyrë diskriminuese, të cilat mund të favorizojnë disa prej pjesëmarrësve.

Autoriteti/enti kontraktor nuk u tregon pjesëmarrësve të tjerë, zgjidhjet e propozuara ose informacionin konfidencial që është komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në dialog, pa pëlqimin e këtij të fundit.

10. Gjatë fazës së dialogut, autoriteti/enti kontraktor, synon që ofertat të qartësohen, specifikohen dhe të përshtaten sipas kërkesës dhe nevojës së autoritetit/entit kontraktor. Megjithatë, ky qartësim, specifikim, përshtatje ose informacion shtesë nuk duhet të përfshijë ndryshime në aspektet kryesore të ofertës, duke përfshirë nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose ftesën për ofertë, të cilat mund të shtrembërojnë konkurrencën ose të kenë efekt diskriminues.

    Nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose ftesën për ofertë, nuk mund të ndryshohen në këtë fazë, pasi do të përfitohej një kontratë e ndryshme nga ajo, për të cilën është realizuar procedura e prokurimit.

11. Pasi të ketë arritur në një zgjidhje të kënaqshme, autoriteti/enti kontraktor deklaron mbylljen e dialogut dhe informon pjesëmarrësit që kanë mbetur për përfundimin e kësaj faze.

12. Autoriteti/enti kontraktor i kërkon secilit prej pjesëmarrësve të mbetur në garë, të paraqesin ofertat përfundimtare në bazë të zgjidhjes ose zgjidhjeve të paraqitura dhe të specifikuara gjatë dialogut. Këto oferta përmbajnë të gjithë elementet e kërkuar dhe të nevojshëm për realizimin e projektit.

13. Autoriteti/enti kontraktor shqyrton dhe vlerëson ofertat e marra dhe mund t'i kërkojë ofertuesit që ka dorëzuar ofertën me raportin më të mirë çmim-cilësi, sipas parashikimeve në LPP, përmes negociatave, të konfirmojë angazhimet financiare ose kushtet e tjera që përmban oferta, duke finalizuar kushtet e kontratës, nëse kjo nuk ndikon në ndryshimin e aspekteve thelbësore të ofertës, nevojave dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë, të cilat mund të shtrembërojnë konkurrencën ose të kenë efekt diskriminues.

14. Nëse autoriteti/enti kontraktor ka parashikuar pagesa për pjesëmarrësit në dialog, në varësi të natyrës dhe kostos që ka objekti i prokurimit, kur një gjë e tillë është njoftuar në njoftimin e kontratës dhe/ose ftesën për ofertë, do ta kryejë pagesën pas nënshkrimit të kontratës me ofertuesin fitues.

Neni 51
Partneriteti për inovacion

1. Partneriteti për inovacion është procedurë prokurimi me faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor vetëm në rastet e parashikuara në nenin 46 të LPP-së, kur si rregull mallrat, punët ose shërbimet që kërkohen të prokurohen nuk janë produkte të gatshme në treg dhe produkti i përfituar në përfundim të kontratës është një inovacion.

   Autoriteti/enti kontraktor duhet të bëjë të qartë në dokumentet e tenderit, faktin që partneriteti për inovacion ka si qëllim zhvillimin e një produkti, shërbimi apo pune inovatore dhe blerjen më pas të mallrave, shërbimeve ose punëve që rezultojnë prej tyre nëse ato përkojnë me nivelet e performancës dhe kostot minimale të dakordësuara ndërmjet autoritetit ose entit kontraktor dhe pjesëmarrësve. Në këtë kuadër, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë edhe objektiva të ndërmjetme, të cilat duhet të arrihen nga partnerët/kontraktuesit dhe pagesat përkatëse që do të bëhen sipas një plani të caktuar.

2. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 77, të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.

3. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, njoftimi i kontratës shoqërohet me ftesën për shprehje interesi për procedurën e prokurimit. Çdo operator ekonomik i interesuar mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit, në përgjigje të njoftimit të kontratës apo edhe të njoftimit periodik të informacionit në rastin e kontratave sektoriale, duke dhënë informacionin që kërkohet, nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 46 të LPP-së. Autoriteti/enti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë.

   Nëse do të përdorë këtë mundësi, autoriteti/enti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e kontratës, ku duhet të përcaktojë dhe numrin minimal të

kandidatëve që synon të ftojë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.

6. Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 110 të LPP-së, autoriteti/enti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur për të paraqitur një ofertë fillestare. Vetëm ata operatorë ekonomikë që ftohen nga autoriteti/enti kontraktor, pasi ky i fundit ka vlerësuar informacionin e kërkuar, mund të dorëzojnë projekte kërkimi dhe inovacioni, që kanë si qëllim përmbushjen e nevojave të autoritetit/entit kontraktor, të cilat nuk mund të përmbushen nëpërmjet zgjidhjeve ekzistuese.

7. Në këtë procedurë kontrata jepet vetëm mbi bazën e kriterit të raportit çmim-cilësi, sipas parashikimeve në LPP.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të vendosë që të krijojë partneritet për inovacion me një partner ose disa partnerë që kryejnë veprimtari të veçanta kërkimi dhe zhvillimi.

9. Autoriteti/enti kontraktor zhvillon faza të njëpasnjëshme me pjesëmarrësit e përzgjedhur sipas parashikimeve në LPP, bazuar në hapat e procesit të kërkimit dhe zhvillimit me qëllim identifikimin dhe përcaktimin e mjeteve që përshtaten më mirë me nevojat e tyre. Fazat e njëpasnjëshme mund të përfshijnë prodhimin e produkteve, ofrimin e shërbimeve ose përfundimin e punëve.

   Autoriteti/enti kontraktor negocion me ofertuesit, sipas parashikimeve në LPP, ofertat fillestare dhe të gjitha ofertat pasuese që ata kanë dorëzuar për të përmirësuar përmbajtjen e tyre, përveç ofertës përfundimtare.

   Kërkesat minimale dhe kriteret e përzgjedhjes nuk janë objekt negociimi. Nevojat dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose ftesën për ofertë, nuk mund të ndryshohen në këtë fazë, pasi do të përfitohej një kontratë e ndryshme nga ajo, për të cilën është realizuar procedura e prokurimit.

10. Autoriteti/enti kontraktor informon me shkrim të gjithë ofertuesit, të cilët kalojnë në fazën tjetër, për çdo ndryshim në specifikimet teknike ose dokumente të tjera të tenderit, përveç atyre që përcaktojnë kërkesat minimale. Pas këtyre ndryshimeve, autoriteti/enti kontraktor parashikon një kohë të mjaftueshme që ofertuesit të modifikojnë dhe të dorëzojnë përsëri ofertat e ndryshuara, sipas rastit.

    Negociatat gjatë procedurave të partneritetit për inovacion mund të zhvillohen në faza të njëpasnjëshme, për të ulur numrin e ofertave që do të negociohen bazuar në kriteret e përzgjedhjes, kur autoriteti/enti kontraktor e ka njoftuar këtë mundësi në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë.

Autoriteti/enti kontraktor siguron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit, dhe në asnjë rast nuk jep informacione në mënyrë diskriminuese, të cilat mund të favorizojnë disa prej pjesëmarrësve.

Autoriteti/enti kontraktor nuk u tregon pjesëmarrësve të tjerë, zgjidhjet e propozuara ose informacionin konfidencial që është komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në negociata, pa pëlqimin e këtij të fundit.

11. Autoriteti/enti kontraktor garanton që struktura e partneritetit dhe, në veçanti, kohëzgjatja dhe vlera e fazave të ndryshme të pasqyrojë shkallën e inovacionit të zgjidhjes së propozuar dhe rendin e veprimtarive të kërkimit dhe inovacionit të nevojshme për zhvillimin e një zgjidhjeje inovatore ende të padisponueshme në treg. Vlera e parashikuar e mallrave, shërbimeve ose punëve duhet të jetë në proporcion me investimin që kërkohet për realizimin e tyre.

12. Bazuar mbi objektivat e vendosura nga autoriteti/enti kontraktor dhe rezultatet për çdo fazë, ai mund të vendosë që ta përfundojë partneritetin për inovacion pas çdo faze, ose, në rastin e partneritetit për inovacion me disa partnerë, të reduktojë numrin e tyre, duke zgjidhur kontratat individuale. Në çdo rast, një mundësi e tillë dhe kushtet për përdorimin e saj duhet të parashikohet qartësisht në dokumentet e tenderit.

13. Duke qenë se, produktet e përfituara nga kjo procedurë janë në vetvete zgjidhje inovatore, autoriteti/enti kontraktor përcakton rregullat e zbatueshme për të drejtat e pronësisë intelektuale në dokumentet e tenderit. Në rastin e një partneriteti për inovacion me disa partnerë, bazuar mbi parimet e konfidencialitetit të parashikuara në këtë ligj, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet t'u tregojë partnerëve të tjerë zgjidhjet e propozuara ose informacione të tjera konfidenciale të komunikuara nga një partner në kuadrin e partneritetit, pa pëlqimin e tij.

Neni 52
Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

1. Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, është procedurë prokurimi me faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, vetëm në rastet e parashikuara në nenin 47 të LPP-së, kur:

a) në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme të hapura ose të hapura të thjeshtuara, [54]ose procedurës së kufizuar apo në përgjigje të një procedure të publikuar për konkurrim të lidhur me aktivitetet sektoriale sipas kreut VIII të LPP-së, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje, ose kur ofertat apo kërkesat për pjesëmarrje të dorëzuara kanë qenë të papërshtatshme. Në çdo rast, kushtet fillestare të kontratës nuk duhet të kenë pësuar ndryshime thelbësore.

   Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor mund të përdorë procedurën me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, kur në përgjigje të procedurës negociim me shpallje paraprake të njoftimit, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje ose ato që janë dorëzuar kanë qenë të papërshtatshme, duke pasur parasysh që kushtet fillestare të kontratës të mos kenë pësuar ndryshime thelbësore.

   Ofertat dhe kërkesa për pjesëmarrje, konsiderohen si të papërshtatshme, kur mangësitë nuk kanë lidhje me kontratën dhe duket qartë që nuk mund të plotësojnë, pa pësuar ndryshime thelbësore, nevojat dhe kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, të specifikuara në dokumentet e tenderit, si edhe kur operatori ekonomik ndodhet në kushtet e skualifikimit sipas nenit 76 të LPP-së, ose nuk përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor sipas nenit 77 të LPP-së.

   Në çdo rast, mosdorëzimi i asnjë oferte apo kërkese për pjesëmarrje nuk duhet të vijë si shkak i gabimeve të bëra në dokumentet e tenderit dhe/ose për shkak të ndonjë veprimi të autoritetit/entit kontraktor.

b) kur punët, mallrat apo shërbimet mund të ofrohen vetëm nga një operator ekonomik i caktuar, për një nga arsyet e mëposhtme:

   i. qëllimi i prokurimit është krijimi ose blerja e një vepre arti ose performance artistike unike;
   ii. për arsye teknike, nuk ka konkurrencë;
   iii. për të mbrojtur të drejtat ekskluzive, duke përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale.

   Përjashtimet e përcaktuara në paragrafët "ii" dhe "iii" zbatohen vetëm kur nuk ekziston asnjë alternativë ose zëvendësim i arsyeshëm, dhe mungesa e konkurrencës nuk vjen si rezultat i kufizimit të kërkesave që autoriteti/enti kontraktor përcakton për objektin e prokurimit. Ekzistenca e këtyre kushteve duhet të vërtetohet e të dokumentohet nga autoritetet ose entet kontraktore.

[54] Hequr "sherbim konsulence" me VKM 498/2024

c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti/enti kontraktor, afatet kohore për procedurat e hapura, procedurat e hapura të thjeshtuara, procedurat e kufizuara, [55]procedurat konkurruese me negociim, ose procedurat me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit në kontratat sektoriale, nuk mund të respektohen. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga autoriteti/enti kontraktor.

Në këtë rast, duhet të plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. Konstatimi i një ngjarjeje të paparashikuar;
ii. Autoriteti/enti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen;
iii. Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshme të një komuniteti të gjerë;
iv. Nuk është e mundur të ndiqen procedurat konkurruese mbi ose nën kufirin e ulët monetar.

Në të gjitha rastet, autoriteti/enti kontraktor duhet të vërtetojë, të argumentojë dhe të dokumentojë se nevoja ekstreme e konstatuar, nuk është shkaktuar nga veprimi a mosveprimi i tij.

Neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.

Kjo procedurë nuk mund të zbatohet për të justifikuar lidhjen e kontratave afatgjata, por vetëm për përballimin e nevojës ekstreme.

Me krijimin e nevojës ekstreme, autoriteti/enti kontraktor duhet njëkohësisht, të marrë të gjitha masat për realizimin e procedurave normale të prokurimit.

Për kontratat e nënshkruara në përfundim të një procedure prokurimi sipas kësaj shkronje, nuk mund të përdoret procedura me negociim, pa shpallje paraprake për mallra, shërbime ose punë shtesë, sipas parashikimeve në këtë nen.

ç) Kjo procedurë mund të përdoret për kontratat publike të mallrave:

i. kur produktet e përfshira janë prodhuar vetëm për arsye kërkimi, eksperimentimi, studimi ose zhvillimi. Kontratat që jepen në zbatim të

[55] Heque "sherbim konsulence" me VKM 498/2024

kësaj pike nuk përfshijnë prodhimin në masë për të arritur qëndrueshmëri tregtare, ose për të mbuluar kostot e kërkimit dhe të zhvillimit.

ii. për dorëzime shtesë nga furnizuesi fillestar, të cilat janë ose një zëvendësim i pjesshëm i mallrave apo instalimeve ose si shtesë e mallrave apo instalimeve ekzistuese, kur një ndryshim i furnizuesit do ta detyronte autoritetin ose entin kontraktor të marrë mallra me karakteristika të ndryshme teknike, të cilat do të rezultonin në papërputhshmëri ose në vështirësi teknike joproporcionale në shfrytëzim dhe mirëmbajtje.

Kontrata, në këtë rast, duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor brenda tre viteve nga lidhja e kontratës fillestare dhe vlera e këtyre furnizimeve nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Ky përcaktim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Situata e parashikuar në këtë pikë nuk zbatohet për ato lloj mallrash, për të cilat autoriteti/enti kontraktor ka nevoja të vazhdueshme.

iii. për mallrat e kuotuara dhe të blera në bursë;

iv. për blerjet e mallrave me kushte veçanërisht të favorshme, nga një furnitor që mbyll përfundimisht veprimtarinë e tij tregtare, është në proces falimenti, nga një marrëveshje me kreditorët ose sipas një procedure të ngjashme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

d) Kjo procedurë mund të përdoret për kontratat publike të shërbimit kur kontrata në fjalë pason një konkurs projektimi të organizuar në përputhje me LPP-në dhe, sipas rregullave të parashikuara në konkursin e projektimit, duhet t'i jepet fituesit ose njërit prej fituesve të konkursit të projektimit; në rastin e dytë të gjithë fituesit duhet të ftohen të marrin pjesë në negociata.

dh) Procedura me negociim pa shpallje paraprake mund të përdoret për punë ose shërbime të reja që kanë të bëjnë me përsëritje të punëve apo shërbimeve të ngjashme, që i janë besuar një operatori ekonomik, të cilit autoriteti/enti kontraktor i ka dhënë kontratën fillestare, me kusht që këto punë ose shërbime të përputhen me projektin bazë, për të cilin është lidhur kontrata fillestare mbi bazën e një procedure konkurruese. Në projektin bazë duhet të cilësohet niveli i punëve ose shërbimeve shtesë dhe kushtet, sipas të cilave ato do të jepen.

Situata e parashikuara në këtë pikë nuk zbatohet për ato lloj shërbimesh, për të cilat autoriteti kontraktor ka nevoja të vazhdueshme.

Përdorimi i mundshëm i kësaj procedure duhet të bëhet i ditur që në momentin e shpalljes së procedurës së parë, dhe autoriteti ose enti

kontraktor, gjatë përllogaritjes së fondit limit duhet të marrë parasysh edhe një kosto të përgjithshme të punëve ose shërbimeve shtesë.

Kjo procedurë mund të përdoret vetëm brenda tre viteve nga data e lidhjes së kontratës fillestare, dhe vlera nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare. Ky përcaktim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorale.

2. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 77, të këtyre rregullave, duhet të paraqesë arsyet e përdorimit të kësaj procedure.

3. Me përjashtim të rrethanave të parashikuara në pikat 1, shkronja "b", 2, shkronjat "b", "c" dhe "ç", 3 dhe 4, të nenit 47, të LPP-së, autoriteti/enti kontraktor fton jo më pak se 3 (tre) kandidatë, duke garantuar konkurrencë dhe barazi ndërmjet tyre.

   Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e kandidatëve që do të ftojë.

4. Kur autoriteti/enti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, duhet të provojë se kandidatët plotësojnë minimalisht kërkesat e nenit 76 dhe 77 të LPP-së.

5. Në rastin e procedurës së prokurimit me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen, afatet kohore parashikohen nga vetë autoriteti/enti kontraktor, në varësi të objektit të prokurimit dhe rrethanave, duke krijuar mundësinë që operatorët ekonomikë të ftuar të kenë mundësinë e përgatitjes së ofertës dhe të jenë të mos diskriminohen.

Neni 53
Procedura me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, për kontratat sektoriale

1. Procedura me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës është një procedurë prokurimi me faza, e cila përdoret vetëm për prokurimin e kontratave sektoriale në rrethanat e parashikuara në nenin 48 të LPP-së.

2. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 77 të këtyre rregullave, duhet të japë arsyet për përdorimin e kësaj procedure.

3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 48 të LPP-së. Enti kontraktor mund të përllogarisë afate më të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

4. Njoftimi i kontratës ose ftesa për shprehje interesi për procedurën e prokurimit sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit, duke dhënë informacionin që kërkohet, nga enti kontraktor.

5. Enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në negociim, në përputhje me parashikimet e LPP dhe të këtyre rregullave.

   Nëse do të përdorë këtë mundësi, enti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e kontratës, ku duhet të përcaktojë dhe numrin minimal të kandidatëve që synon të ftojë dhe, sipas rastit, numrin maksimal.

6. Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 110 të LPP-së, enti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur për të negociuar. Vetëm ata operatorë ekonomikë që ftohen nga enti kontraktor, pasi ky i fundit ka vlerësuar informacionin e kërkuar, mund të marrin pjesë në negociim.

7. Në këtë procedurë kontrata jepet vetëm mbi bazën e kriterit të raportit çmim-cilësi, sipas parashikimeve në LPP.

8. Negociimi mund të zhvillohet në disa faza, deri në përcaktimin e ofertës fituese.

   Enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të ftuar në këtë fazë, vetëm nsëe enti kontraktor e ka njoftuar këtë mundësi në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë.

   Enti kontraktor nëse nuk bie dakord me të gjithë pjesëmarrësit për afatin ndërmjet fazave, cakton një afat të arsyeshëm, por jo më të shkurtër se afatet e parashikuara në nenin 48 të LPP-së, dhe njofton pjesëmarrësit në kohë.

   Enti kontraktor siguron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit, dhe në asnjë rast nuk jep informacione në mënyrë diskriminuese, të cilat mund të favorizojnë një ose disa prej pjesëmarrësve.

Enti kontraktor nuk u tregon pjesëmarrësve të tjerë, zgjidhjet e propozuara ose informacionin konfidencial që është komunikuar nga një kandidat ose një ofertues që merr pjesë në negociim, pa pëlqimin e këtij të fundit.

Neni 54[56]

Neni 55
Procedurë e hapur e thjeshtuar

1. Procedura e hapur e thjeshtuar është një procedurë me një fazë, që mund përdoret nga autoriteti kontraktor për kontrata nën kufirin e ulët monetar, sipas parashikimit në nenin 49, të LPP-së.

2. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë në këtë procedurë.

3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 49, të LPP-së.

4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së bisnesit të vogël dhe të mesëm.

   Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

   Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:

   a) Për kontratat e punëve:

      i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit[57] që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

[56] Shfuqizuar neni 54 "Sherbim konsulence" me VKM 498/2024
[57] Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

5. Shqyrtimi i ofertave duhet të bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dorëzimi i ofertave.

6. Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit të ofertuesve, në bazë të kritereve të përcaktuara në nenet 76 e 77, të LPP-së dhe këtyre rregullave, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 87, të LPP-së.

Neni 56
Procedura e prokurimit me vlerë të vogël

1. Autoriteti/enti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime, kur vlera e përllogaritur është ndërmjet kufijve nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë në vit, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 41, të LPP-së.

2. Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.

   Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup - mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.

3. Titullari i autoritetit/entit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në fillim të vitit kalendarik, ngre një komision të veçantë, të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh, nga të cilët njëri është kryetar.

4. Titullari i autoritetit/entit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre.

Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit/entit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës, duhet të përllogarisë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 76 të këtyre rregullave, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme.
Në rastin kur në përllogaritjen e fondit përdoret metoda e testimit të tregut, nuk është e domosdoshme të administrohen ofertat e marra në kuadër të këtij procesi, por vetëm treguesit e çmimeve, të cilat dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël.[58]
Urdhri i prokurimit duhet të shoqërohet me ftesën për ofertë, që iu drejtohet operatorëve ekonomikë, në të cilën përcaktohen të gjitha të dhënat e nevojshme që lidhen me objektin e prokurimit.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, autoriteti kontraktor publikon ftesën për ofertë, në sistemin e prokurimit elektronik, ku mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar.

   Afati i fundit për pranimin dhe hapjen e ofertave nuk duhet të jetë ditë pushimi (e shtunë, e diel, festë zyrtare).

6. Në çdo rast, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet autoritetit/entit kontraktor, brenda afatit të përcaktuar nga ky i fundit në ftesën për ofertë.

   Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet të njoftojë autoritetin/entin kontraktor brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë. Në njoftim duhet të jepen arsyet, që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

   Autoriteti/enti kontraktor mund të refuzojë ofertën e paraqitur nga një operator ekonomik, i cili në një procedurë të mëparshme prokurimi me vlerë të vogël, të zhvilluar nga ky autoritet/ent brenda periudhës një vjecare nga data e zhvillimit të kësaj procedure, nuk e ka njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë mbi arsyet që kanë çuar në pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit.

   Kur ofertuesi i renditur në vend të parë tërhiqet nga oferta e tij ose nuk plotëson kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, ky i fundit përzgjedh ofertuesin e

[58] Shtuar me VKM 498/2024

renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me radhë, deri në ofertuesin e renditur në vend të dhjetë.

Këto veprime duhet të dokumentohen nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të kontratës vetëm operatorët ekonomikë të renditur deri në vendin e dhjetë të klasifikimit.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të kontratës vetëm operatorët ekonomikë, oferta e të cilëve, nuk është ulur më shumë se 50 % e fondit limit të përllogaritur.

Kryerja e procedurës me mjete elektronike të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

7. Në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, nuk zbatohen dispozitat e LPP për ofertat anomalisht të uleta.

8. Në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël zbatohen parashikimet e nenit 116 të LPP-së, për ankimin administrativ.

9. Autoriteti/enti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për blerjen e mallrave, për të cilat ka një nevojë emergjente apo për kryerjen e shërbimeve të paparashikueshme me kusht që vlera e përllogaritur e mallrave dhe shërbimeve, për plotësimin e nevojave të lidhura me situatën e paparashikuar, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë. Në të tilla raste emergjence ose ku prania e komisionit është e pamundur, prokurimet mund të kryhen edhe nga persona që nuk janë anëtarë të komisionit.

10. Pagesa për prokurimet me vlerë të vogël bëhet sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta sipas legjislacionit në fuqi. Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë mundur të nënshkruajnë një të tillë.

11. Në asnjë rast, autoriteti/enti kontraktor në momentin e planifikimit të nevojave të tij, nuk duhet të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat e prokurimit.

Neni 57
Konkursi i projektimit

1. Konkursi i projektimit është një procedurë prokurimi me faza, sipas nenit 104, të LPP-së, nëpërmjet së cilës, autoriteti/enti kontraktor përzgjedh një studim ose projekt, që ka kryesisht natyrë estetike, duke i mundësuar autoritetit/entit kontraktor që të blejë, kryesisht, në fushat e planifikimit urban dhe rural, arkitekturës dhe inxhinierisë ose përpunimit të të dhënave, një plan ose projekt.

2. Konkursi i projektimit mund të organizohet si pjesë e një procedure, që shërben për përfitimin e një projekti ose për përcaktimin e një fituesi të një kontrate shërbimi publik.

   a) Në rastin kur autoriteti/enti kontraktor organizon një konkurs projektimi, ku objekti është një projektide, në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohen qartë kriteret e vlerësimit teknik, çmimi dhe/ose rimbursimet që jepen për kandidatin fitues dhe për kandidatët e tjerë të pranuar.
   b) Në rastin kur autoriteti/enti kontraktor organizon konkurs projektimi, si pjesë të një procedure që çon në përzgjedhjen e kontratës fituese për shërbime, mund të përdorë procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit për kryerjen e shërbimit me kandidatin e suksesshëm të dalë në përfundim të konkursit të projektimit, në përputhje me pikën 3, të nenit 47, të LPP-së.

3. Në çdo rast, në dokumentet e tenderit, autoriteti/enti kontraktor duhet të bëjë të njohur qëllimin e tij për të marrë vetëm një projektide apo për të marrë projektide dhe shërbimin në lidhje me këtë projektide.

4. Nuk mund të jenë në cilësinë e kandidatëve në një konkurs projektimi, punonjës të autoritetit/entit kontraktor, i cili zhvillon këtë konkurs.

5. Hapat e procedurës së konkursit të projektimit janë, si më poshtë vijon:

   a) Titullari i autoritetit/entit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit, sipas parashikimeve të nenit 77 të këtyre rregullave. Për këtë lloj procedure prokurimi, urdhri i prokurimit nuk përmban fondin limit.
   b) Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla.

      Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë.

Nëse do të përdorë këtë mundësi, autoriteti/enti kontraktor duhet ta bëjë të ditur në njoftimin e konkursit. Në çdo rast, numri i kandidatëve të zgjedhur duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar konkurrencë të drejtë.

c) Afatet kohore për dorëzimin e kërkesave për shprehjen e interesit janë ato të përcaktuara në nenin 105, të LPP-së.

ç) Autoriteti/enti kontraktor shqyrton kualifikimet e kandidatëve që kanë shprehur interes në bazë të kritereve për kualifikim, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e hapjes së procedurës. Në përfundim të kësaj faze, kandidatët e kualifikuar përshihen në një listë të shkurtër, e cila duhet të përmbajë të paktën dy kandidatë.

d) Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fton kandidatët e përcaktuar në listën e shkurtër për paraqitjen e propozimeve të tyre. Ftesa përfshin qëllimin e autoritetit/entit kontraktor, adresën, datën dhe orën e përcaktuar për dorëzimin e propozimeve.

Ftesa shoqërohet me udhëzimet e nevojshme për ofertuesit, ku jepet i gjithë informacioni që do t'i ndihmonte për përgatitjen e propozimeve.

dh) Autoriteti/enti kontraktor përcakton një afat kohor për dorëzimin e propozimeve, që u jep ofertuesve kohë të mjaftueshme për të përgatitur propozimet e tyre.

Afati kohor për dorëzimin e propozimeve është, si më poshtë vijon:

- Në procedurën e konkursit të projektimit, me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 20 (njëzet) ditë nga data në të cilën është dërguar ftesa për ofertë te kandidatët;
- Në procedurën e konkursit të projektimit, me vlerë nën kufirin e lartë monetar, afati minimal kohor për dorëzimin e ofertës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data, në të cilën është dërguar te kandidatët ftesa për ofertë.

Gjatë kësaj kohe, ofertuesit mund të kërkojnë sqarime për informacionet e dhëna në kërkesën për propozime. Autoriteti/enti kontraktor bën sqarimet përkatëse dhe ua dërgon të gjithë kandidatëve të përcaktuar në listën e shkurtër. Nëse është e nevojshme, autoriteti/enti kontraktor zgjat afatet kohore për dorëzimin e propozimeve, duke argumentuar dhe dokumentuar nevojën për këtë zgjatje.

Pas mbarimit të afateve kohore për dorëzim nuk duhet të pranohet asnjë ndryshim i propozimeve.

Propozimet, hapen pas mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e tyre. Çdo propozim që merret pas mbarimit të afatit, kthehet i pahapur.

e) Vlerësimi i propozimeve bëhet brenda 20 (njëzet) ditëve nga afati i përfundimtar i përcaktuar për hapjen e tyre dhe u komunikohet ofertuesve pjesëmarrës. Në varësi të kompleksitetit të objektit, ky afat mund të shtyhet duke argumentuar dhe dokumentuar arsyet konkrete. Procesi i vlerësimit regjistrohet nëpërmjet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim.
ë) Juria e vlerësimit duhet të përbëhet nga një numër tek anëtarësh (të paktën tre), pjesëtarë ose jo të autoritetit/entit kontraktor. Nëse nga pjesëmarrësit në konkurs kërkohet kualifikim i posaçëm profesional, së paku një e treta e anëtarëve të komisionit të jurisë duhet të kenë kualifikime të njëjta ose të barazvlefshme profesionale si pjesëmarrësit, si dhe një përvojë 10 vjeçare në çështjet e projektit që do të prokurohet.
f) Juria shqyrton projektet e paraqitura nga kandidatët, në mënyrë anonime dhe vetëm mbi bazën e kritereve të përcaktuara në njoftimin për konkurs. Anonimiteti i projekteve duhet të respektohet deri në momentin që juria merr vendimin e saj.
g) Juria është e pavarur në vendimet dhe opinionet e saj. Nëse është e nevojshme, juria fton kandidatët për t'ju përgjigjur pyetjeve që ka regjistruar në procesverbal, për të sqaruar çdo aspekt të planeve apo projekteve të paraqitura. Këto diskutime regjistrohen në një procesverbal.
gj) Në vijim, juria harton një raport, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët, ku pasqyrohet renditja sipas cilësisë të planeve ose projekteve dhe komentet apo vërejtjet konkrete.

KREU VII
MJETET E PROKURIMIT

Neni 58
Mjetet e prokurimit

Në procesin e prokurimit, autoriteti/enti kontraktor mund të përdorë këto mjete prokurimi:

a) Marrëveshja kuadër;
b) Prokurimi i përqendruar dhe delegimi i prokurimit;
c) Sistemi dinamik i blerjes.

Neni 59
Përdorimi i marrëveshjes kuadër

1. Autoriteti/enti kontraktor përdor marrëveshjen kuadër për punë/mallra/shërbime, për të arritur një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve/enteve kontraktore dhe një apo më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Qëllimi i një marrëveshjeje kuadër është të vendosë kushtet e kontratave që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasitë e parashikuara, sipas përcaktimit në nenin 52, të LPP-së.

Neni 60
Palët në një marrëveshje kuadër

1. Një marrëveshje kuadër mund të lidhet ndërmjet:

   a) disa autoriteteve/enteve kontraktore dhe disa operatorëve ekonomikë;
   b) disa autoriteteve/enteve kontraktore dhe një operatori ekonomik;
   c) një autoriteti/enti kontraktor dhe disa operatorëve ekonomikë;
   ç) një autoriteti/enti kontraktor dhe një operatori ekonomik.

2. Në njoftimin e procedurës së prokurimit duhet të përcaktohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore përfituese. Nuk mund të bëhen pjesë e një marrëveshje kuadër autoritetet/entet kontraktore, të cilat nuk janë palë e marrëveshjes kuadër që në publikimin e saj.

   Pas nënshkrimit të marrëveshjes, nuk lejohet të pranohen operatorë ekonomikë të tjerë, të cilët nuk janë palë në këtë marrëveshje.

3. Operatorët ekonomikë, që janë palë në një marrëveshje kuadër, nuk mund të krijojnë një bashkim operatorësh ekonomikë dhe të paraqesin ofertë për një kontratë, pasi janë bërë palë e kësaj marrëveshjeje kuadër.

4. Operatori ekonomik, që është palë në një marrëveshje kuadër, nuk mund të caktohet si nënkontraktor i një operatori ekonomik tjetër, që i është dhënë kontrata sipas së njëjtës marrëveshje kuadër.

Neni 61
Qëllimi i përdorimit dhe detyrimet që rrjedhin nga një marrëveshje kuadër

1. Një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur dhe/ose kur është e vështirë ose e

pamundur për të përcaktuar paraprakisht volumet që duhet të prokurohen, dhe nuk ka siguri për kohën e ekzekutimit të kontratave.

2. Një marrëveshje kuadër është ligjërisht e detyrueshme për të dyja palët. Autoriteti/enti kontraktor nuk është i detyruar të prokurojë një sasi të caktuar mallrash/shërbimesh/punësh të përfshira në marrëveshje, por, në çdo rast gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër, autoritetet/entet kontraktore nuk lejohen të blejnë nga asnjë operator ekonomik tjetër të njëjtat mallra/shërbime/punë të mbuluara nga një marrëveshje kuadër, pasi kjo do të konsiderohej një shkelje e marrëveshjes.

Neni 62
Rregulla për prokurimin e marrëveshjes kuadër

1. Autoritetet/entet kontraktore mund të lidhin një marrëveshje kuadër nëpërmjet procedurave të prokurimit të parashikuara në LPP.

2. Njoftimi për marrëveshjen kuadër hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit publik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë në procedurën për dhënien e një marrëveshjeje kuadër.

3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 52, të LPP-së.

4. Përllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër bëhet, si më poshtë vijon:

   a) Vlera e parashikuar e një marrëveshjeje kuadër duhet të përfshijë shumën e përllogaritur të të gjitha vlerave të kontratave që parashikohen të jepen gjatë kohës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.
   b) Në rastin kur, autoriteti/enti kontraktor e ka të pamundur të përcaktojë sasinë e objektit të prokurimit, për efekt të përllogaritjes së vlerës së marrëveshjes kuadër duhet t'u referohet, për aq sa është e mundur, nevojave të planifikuara dhe/ose nevojave të mëparshme për këtë objekt. Në çdo rast, përllogaritja e nevojave duhet të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e situatave kur dalin nevoja të reja, për të njëjtin objekt, të papërfshira në marrëveshjen kuadër.

5. Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të neneve 80 dhe 87, të LPP-së. Në rast se autoriteti/enti kontraktor e ka objektivisht të pamundur të përcaktojë sasinë që do të prokurohet, atëherë do të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi.

Kur, autoriteti/enti kontraktor vendos vlerësimin e ofertave mbi bazën e "çmim për njësi", përveç vlerës së pritshme të kontratave përllogarit edhe shumatoren e çmimeve për njësi për çdo artikull apo shërbim, e cila publikohet bashkë me vlerën e pritshme të kontratave, në njofimin e kontratës. Në këtë rast, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Për efekt krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi, të përllogaritur për çdo artikull apo shërbim nga autoriteti/enti kontraktor[59].

Kjo metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore, kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar.

6. Nëse një operator ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër, nuk përmbush më kriteret e kualifikimit, për të cilat është shpallur fitues në këtë marrëveshje, është i detyruar të njoftojë autoritetin/entin kontraktor menjëherë, por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti i ndodhjes së një ndryshimi të tillë. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton mospërmbushjen e këtij detyrimi, duhet të veprojë në përputhje me nenin 78, të LPP-së.

7. Në rast se operatorët ekonomikë palë në një marrëveshje kuadër, për shkak të forcës madhore (lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, pandemitë[60], shtrëngime të karantinës dhe embargo transiti) nuk mundet që të furnizojnë autoritetin/autoritetet kontraktore palë në këtë marrëveshje, me një ose disa artikuj/shërbime objekt i kësaj marrëveshje, atëherë vlefshmëria dhe efektiviteti marrëveshjes pushojnë së ekzistuari vetëm për këto artikuj/shërbime, dhe vijon për artikujt/shërbimet e tjera, sipas kushteve të marrëveshjes.

8. Autoriteti/enti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një marrëveshje kuadër në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fton ofertuesin/t fitues për nënshkrimin e marrëveshjes.

Neni 63
Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër

[59] Shtuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021
[60] Shtuar me VKM 498/2024

1. Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër nuk mund të jetë më shumë se 4 (katër) vjet.

2. Në rastin e marrëveshjes kuadër për kontratat sektoriale, ky afat nuk është më i gjatë se 8 (tetë) vjet.

Neni 64
Llojet e marrëveshjes kuadër

1. Llojet e marrëveshjes kuadër janë:

   a) marrëveshje kuadër e lidhur me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara;
   b) marrëveshje kuadër e lidhur me disa operatorë ekonomikë, ku:

      i. të gjitha kushtet janë të përcaktuara;
      ii. jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

2. Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve, për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër.

   Nëse nevojat e autoritetit/entit kontraktor ndryshojnë, atëherë do të duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Një operatori ekonomik i kërkohet të përgatisë ofertën e tij për kontratën bazuar në marrëveshjen kuadër vetëm në lidhje me kushtet, për të cilat është rënë dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër.

3. Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Meqenëse këto marrëveshje kuadër vlerësohen si kontrata, nuk lejohet të bëhen ndryshime të kushteve të tyre, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e kontratës. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re.

   Në rast të përdorimit të kësaj lloj marrëveshjeje, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë në dokumentet e tenderit kushtet që do të zbatohen për dhënien e kontratave brenda marrëveshjes kuadër. Në çdo rast, dhënia e kontratave do të

bëhet pa rihapur konkurrimin, duke u bazuar në kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër.

Kjo lloj marrëveshjeje përdoret në rastin e ndarjes së objektit të prokurimit në lote, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues.

[61]

4. Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, nuk konsiderohen kontrata, sipas LPP-së.

   Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë duhet të lidhen me të paktën tre operatorë ekonomikë. Në rast të kundërt, autoritetet/entet kontraktore mund të lidhin marrëveshje kuadër me ato operatorë ekonomikë që i kanë përmbushur të gjitha kriteret, me kusht që të jenë të paktën dy[62].

   Në rast të përdorimit të kësaj lloj marrëveshjeje, autoriteti/enti kontraktor, për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër, duhet të rihapë konkurrimin.

   Autoriteti/enti kontraktor përgatit një ftesë për ofertë dhe ia dërgon vetëm operatorëve ekonomikë palë të marrëveshjes kuadër, pa bërë njoftim publik. Ftesa për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojë afatin kohor për dorëzimin e ofertave, kriteret për shpalljen e ofertës fituese për kontratën e bazuar në marrëveshjen kuadër dhe çdo informacion të nevojshëm për përgatitjen e ofertave.

   Në këto dokumente duhet, gjithashtu, duhet të specifikohet se, cilat kushte mund t'i nënshtrohen rihapjes së konkurrimit.

   Kriteret për shpalljen e ofertës fituese gjatë rihapjes së konkurrimit mund të jenë të njëjta si ato të marrëveshjes kuadër, ose autoriteti/enti kontraktor mund të përdorë kritere të tjera, me kusht që ato të jenë të përcaktuara në dokumentet fillestare të marrëveshjes kuadër. Këto kritere mund të jenë çmimet për volume të caktuara, informacion për konsulencat për një shërbim intelektual, koha e nevojshme për dorëzim ose orët e nevojshme për kryerjen e punimeve specifike.

   Komunikimi ndërmjet autoritetit/entit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër, për përzgjedhjen e fituesit për kontratat bëhet në

[61] Shfuqizuar paragrafi me VKM 498/2024
[62] Shtuar me VKM 498/2024

formë të shkruar ose elektronike dhe, në çdo rast, duhet të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.

Forma e komunikimit përzgjidhet nga autoriteti/enti kontraktor, në varësi të kohës në dispozicion për përmbushjen e nevojës. Autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për të ruajtur konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertave, deri në vlerësimin përfundimtar të tyre.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t'u dërgojë, në të njëjtën kohë, ftesën për ofertë të gjithë operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër.

Kjo lloj marrëveshjeje kuadër nuk është e zbatueshme në rastet e kontratave sektoriale.

Neni 65
Dhënia e kontratave sipas marrëveshjes kuadër

1. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të zbatojnë kontratën sipas cilësisë dhe çmimit të ofertuar, në kohën e kërkuar prej autoriteteve kontraktore.

2. Për dhënien e kontratave sipas marrëveshjes kuadër zbatohen këto rregulla:

   a) Kontratat mund të jepen mbi bazën e marrëveshjes kuadër përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së saj. Periudha e vlefshmërisë së kontratave të lidhura mbi bazën e një marrëveshjeje kuadër mund të kalojë periudhën e vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.
   b) Në rastin e marrëveshjes kuadër ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, gjatë rihapjes së konkurrimit autoriteti/enti kontraktor krijon një komision vlerësimi për dhënien e një kontrate në bazë të marrëveshjes kuadër.

      Nuk është e detyrueshme që përbërja e komisionit të jetë e njëjtë me atë të komisionit të vlerësimit të ofertave, të përcaktuar për kryerjen e procedurës së prokurimit për marrëveshjen kuadër.

   c) Dhënia e kontratave në bazë të një marrëveshjeje kuadër të realizuar nga një autoritet/ent kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës do të bëhet nga vetë autoritetet/entet kontraktore përfituese.
   ç) Autoritetet/entet kontraktore do t'i japin kontratën ofertuesit, që ka dorëzuar ofertën më të mirë, në bazë të kritereve të shpalljes së kontratës fituese, të përcaktuara në dokumentet e tenderit të marrëveshjes kuadër.
   d) Në një marrëveshje kuadër, sasitë e parashikuara janë vetëm "sasi orientuese". Autoriteti/enti kontraktor mund të blejë më pak ose më shumë

se sasitë e parashikuara (por në çdo rast brenda vlerës së përllogaritur të marrëveshjes kuadër).

3. Autoriteti/enti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit[63] për një kontratë bazuar në marrëveshjen kuadër në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla. Në përfundim të afateve të ankimit fton fituesin për nënshkrimin e kontratës.

4. Në rastin e marrëveshjeve kuadër, të realizuara nga një autoritet/ent kontraktor, njoftimi i kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik do të dërgohet për publikim në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti/enti kontraktor.

5. Në rastin e marrëveshjeve kuadër, të realizuara nga një autoritet/ent kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës, njoftimi i lidhjes së kontratës së parë brenda marrëveshjes kuadër do të dërgohet për publikim nga ky i fundit në sistemin e prokurimit elektronik, ndërsa njoftimi për lidhjen e kontratave të tjera të lidhura gjatë një viti kalendarik (minikontratave), do të krijohen dhe dërgohen për publikim nga vetë autoriteti kontraktor përfitues[64].

Neni 66
Ndryshimi i palëve/përfundimi i marrëveshjes

1. Nëse para mbarimit të marrëveshjes kuadër, të nënshkruar me disa operatorë ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër, mbetet vetëm një operator ekonomik, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të japë kontrata sipas kësaj marrëveshjeje kuadër.

   Kur lind një situatë e tillë, autoriteti/enti kontraktor është i detyruar të njoftojë menjëherë operatorin ekonomik të mbetur në marrëveshjen kuadër. Vlefshmëria dhe efektiviteti i marrëveshjes kuadër pushojnë së ekzistuari me këtë njoftim.

2. Në rast se një operator ekonomik nuk i përgjigjet dy herë radhazi ftesës së autoritetit kontraktor gjatë rihapjes së konkurrimit, ky operator nuk do të jetë më palë e marrëveshjes kuadër.
   Në rastin kur kontrata e bazuar në marrëveshjen kuadër të lidhur me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ndërpritet për faj

[63] Shtuar me VKM 498/2024
[64] Ndryshuarme VKM 498/2024

të operatorit ekonomik, marrëveshja kuadër përfundon, në kushtet kur nuk ka më operator ekonomik palë në këtë marrëveshje.

Neni 67
Prokurimi i përqendruar dhe delegimi i prokurimit

1. Prokurimi i përqendruar mund të përdoret kur:

   a) blerja e përqendruar mundëson përfitime ekonomike për shkak të rritjes së sasisë së mallrave, punëve ose shërbimeve homogjene dhe që ofrohen në treg me kushte të ngjashme;
   b) autoriteti kontraktor, që luan rolin e organit qendror blerës, ka njohuri të mjaftueshme për zhvillimin e procedurave të prokurimit për mallrat, punët ose shërbimet që do të prokurohen.

2. Në përputhje me nenin 53 të LPP dhe me qëllim realizimin dhe përdorimin më të mirë të fondeve publike, Këshilli i Ministrave krijon me vendim, organin qendror blerës, i cili do të kryejë procedura prokurimi në emër dhe për llogari të autoriteteve ose enteve kontraktore sipas sektorëve përkatës, të përcaktuara në vendimin e krijimit të tij.Veprimtaria, që organi qendor blerës do të kryejë, duhet të jetë në zbatim të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe çdo legjislacioni tjetër të zbatueshëm në fuqi[65].

2.1. Këshilli i Ministrave, sipas pikës 2, të nenit 53, të LPP-së, mund të ngarkojë për procedura të veçanta prokurimi një autoritet ose ent tjetër kontraktor si organ qendror blerës apo si ofrues shërbimit të prokurimit që do të zhvillojë procedurën e prokurimit për objekte të caktuara[66].

3. Ministritë ose institucionet e tjera, që kanë në varësi disa autoritete kontraktore, mund të prokurojnë në mënyrë të përqendruar për autoritetet kontraktore të varësisë.

   Në këtë rast, ministritë ose institucionet e tjera, që kanë në varësi disa autoritete kontraktore, mund të përdorin blerjen e përqendruar, duke nxjerrë udhëzimet e duhura për autoritetet kontraktore të varësisë.

4. Nëse disa autoritete kontraktore kanë nevojë të prokurojnë të njëjtin mall, punë ose shërbim, ata mund të bien dakord t'i caktojnë njërit prej tyre rolin e organit qendror blerës për të zhvilluar procedurat e prokurimit në emër të tyre.

[65] Ndryshuar me vKM 498/2024
[66] Ndryshuar me vKM 498/2024

5. Delegimi i prokurimit bëhet kur autoriteti kontraktor nuk ka kapacitete dhe/ose njohuri të mjaftueshme për realizimin e një procedure prokurimi.

6. Nëse një ose disa autoritete kontraktore kanë nevojë të prokurojnë mall/punë ose shërbim, ata mund të bien dakord të delegojnë të drejtën e kryerjes së procedurës së prokurimit një autoriteti tjetër kontraktor për shkak të kapaciteteve që ky i fundit ka në fushën e objektit të prokurimit. Çdo autoritet tjetër kontraktor mund të kërkojë dhe, rrjedhimisht, të bjerë dakord me organin qendror blerës për kryerjen e prokurimit në emër të tij.

7. Organi qendror blerës ose autoriteti kontraktor, të cilit i është deleguar e drejta e prokurimit, është plotësisht përgjegjës për kryerjen e të gjithë procedurës së prokurimit, që nga njoftimi i kontratës deri te publikimi i njoftimit të shpalljes së fituesit, ndërsa nënshkrimi i kontratës bëhet nga vetë autoriteti/et kontraktor/e përfitues/e. Në rastin e përdorimit të marrëveshjes kuadër, procedura e prokurimit për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje bëhet nga organi qendror blerës, ndërsa procedura e minikonkurrimit për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër bëhet nga vetë autoritetet kontraktore përfituese.

8. Në bazë të një marrëveshjeje të shkruar ose të udhëzimeve administrative, organi qendror blerës kryen procedurën e prokurimit në emër të çdo autoriteti kontraktor, ndërsa ky i fundit përcakton specifikimet teknike, sasitë e punëve mallrave /shërbimeve, që do të prokurohen, si dhe fondet përkatëse.

9. Organi qendror blerës shqyrton specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore.

   Nëse organi qendror blerës vlerëson se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me LPP-në ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, kryen rishikimin dhe modifikimin e tyre dhe njofton për këtë autoritetin kontraktor, i cili duhet të konfirmojë, nëse specifikimet e rishikuara/modifikuara përmbushin qëllimin për të cilin nevojitet objekti i prokurimit i kërkuar.

   Për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën me ekspertë të fushës, të institucioneve përgjegjëse, si dhe me ekspertë të jashtëm, vendas ose të huaj, për unifikimin e specifikimeve teknike, në përputhje me standardet.

10. Nëse autoritetet kontraktore, në përcaktimin e të dhënave sasiore kanë marrë për bazë çmime të ndryshme për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën për testimin e tregut dhe përllogarit të dhënat sasiore, sipas fondit përkatës.

Organi qendror blerës duhet të dakordësojë të dhënat sasiore me autoritetin kontraktor, para publikimit të procedurës së prokurimit.

11. Organi qendror blerës mund të kërkojë ndihmën e autoritetit kontraktor, si dhe duhet t'i sigurojë këtij të fundit, sa herë që e kërkon, akses të plotë në çdo informacion për procedurën e prokurimit.

12. Ky nen nuk zbatohet në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale kur autoritetet kontraktore janë ente private.

Neni 68
Sistemi dinamik i blerjes

1. Sistemi dinamik i blerjes është një sistem tërësisht elektronik që mund të përdoret për blerje të përsëritura të punëve, mallrave apo shërbimeve të zakonshme në treg.

2. Autoriteti/enti kontraktor publikon thirrjen për konkurrim ku përcaktohet përdorimi i sistemit dinamik të blerjes dhe përcakton në dokumentet e tenderit të gjithë informacionin e nevojshëm për sistemin dinamik, përfshirë të dhënat teknike mbi funksionimin e sistemit dinamik.

   Njoftimi për sistemin dinamik të blerjes hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me parashikimin në këto rregulla për njoftimin e kontratës.

   Ky njoftim përmban edhe informacionin për hapjen ose intervalet kohore të vlerësimit të kërkesave të reja të paraqitura nga operatorët ekonomikë, për t´u përfshirë në sistemin dinamik të blerjes, përgjatë periudhës së vlefshmërisë së tij.

3. Çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë për t'u bërë pjesë e sistemit dinamik të blerjes përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së tij, në çdo kohë që operatori ka interes për këtë ose përmbush kushtet e vendosura nga autoriteti ose enti për t'u bërë pjesë e sistemit dinamik të blerjes.

   Ky sistem është i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë, që regjistrohen në sistemin e prokurimit elektronik dhe operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet.

4. Për të pasur një sistem dinamik të blerjes, autoriteti/enti kontraktor përdor rregullat e procedurës së kufizuar, duke përfshirë në sistem të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes.

   Kufizimi i numrit të kandidatëve sipas nenit 85, të LPP-së, nuk mund të aplikohet në rastin e sistemit dinamik të blerjes.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të ndajë mallrat, punët apo shërbimet në kategori, duke përcaktuar për secilën prej tyre karakteristikat dhe kriteret e përzgjedhjes, duke krijuar kategoritë përkatëse të sistemit dinamik të blerjes.

6. Për t'u krijuar mundësinë operatorëve ekonomikë që të bëhen pjesë e sistemit dinamik të blerjes në çdo kohë, autoriteti/enti kontraktor u jep akses të plotë dhe të pakufizuar të dokumenteve të tenderit të gjithë operatorëve ekonomikë përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së sistemit dinamik.

7. Hapat për krijimin e sistemit dinamik të blerjes dhe shpalljen e fituesit në përfundim janë:

   a) Autoriteti/enti kontraktor publikon thirrjen për konkurrim dhe sipas rastit specifikon nëse ka një ndarje në kategori të mallrave/ punëve/ shërbimeve;
   b) Autoriteti/enti kontraktor vendos një afat të arsyeshëm, por jo më pak se 20 (njëzet) ditë, për paraqitjen e dokumentacionit për kualifikim nga ana e operatorëve ekonomikë;
   c) Autoriteti/enti kontraktor vlerëson dokumentacionin për kualifikim të paraqitur nga operatorët ekonomikë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga paraqitja e tyre dhe në përfundim të këtij afati, njofton për kualifikimin ose arsyet e skualifikimit nga sistemi dinamik i blerjes;
   ç) Pas përfundimit të afateve të ankimit autoriteti/enti kontraktor përfundon krijimin e sistemit dinamik të blerjes me operatorët e kualifikuar;
   d) Autoriteti/enti kontraktor bën njoftime periodike, sipas përcaktimit në njoftimin për konkurrim, për rifreskimin e dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesit, pjesë e sistemit dinamik të blerjes, dhe zbaton të njëjtat rregulla dhe afate për kualifikimin e operatorëve ekonomike të tjerë.
   dh) kur ka nevojë për punë/ mallra/ shërbime, sipas përcaktimeve për krijimin e sistemit dinamik të blerjes, autoriteti/enti kontraktor u dërgon ftesën për ofertë operatorëve ekonomikë në sistemin dinamik të blerjes, duke u lënë një afat të arsyeshëm, por jo më pak se 48 orë për paraqitjen e një oferte.
   e) Autoriteti/enti kontraktor bën vlerësimin e ofertave sipas nenit 87, të LPP-së dhe përcaktimeve në ftesën për ofertë. Në përfundim të vlerësimit, fton ofertuesin e renditur i pari sa herë është e mundur nënshkruan kontratë.

8. Operatorët ekonomikë, që janë pjesë e sistemit dinamik të blerjes, nëse gjatë afatit të vlefshmërisë së këtij sistemi, humbasin një ose disa nga kapacitetet e nevojshme për kualifikim, duhet të venë në dijeni autoritetitn ose entin kontraktor menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marria dijeni për faktin. Nëse autoriteti/enti kontraktor merr dijeni për një situatë të tillë, por nuk është njoftuar nga operatori ekonomik, vepron sipas parashikimit në nenin 78, të LPP-së.

9. Autoriteti/enti kontraktor përdor sistem të thjeshtuar të blerjes dinamike për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, në përputhje më udhëzimet e APP-së, për të cilin nuk zbatohen parashikimet e nenit 116, të LPP-së, për ankimin administrativ.[67]

KREU VIII
PROKURIMI I KONTRATAVE SEKTORIALE

Neni 69
Entet kontraktore që kryejnë procedura për kontratat sektoriale

1. Do të zbatojnë dispozitat e këtij kreu dhe rregullave të përgjithshme për prokurimin publik, pavarësisht nëse ato operojnë në bazë të një të drejte ekskluzive apo të veçantë, entet kontraktore që kryejnë veprimtari në sektorët e shërbimit, si më poshtë vijon:

   a) Gazi dhe ngrohja, sipas përcaktimit në nenin 60, të LPP-së:

      i. ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t'i ofrojnë publikut shërbime për prodhimin, transportin ose shpërndarjen e gazit ose ngrohjes;
      ii. furnizimin me gaz ose ngrohje të këtyre rrjeteve.

   b) Energjia elektrike, sipas përcaktimit në nenin 61, të LPP-së:

      i. ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t'i ofrojnë publikut, shërbime për prodhimin, transportin ose shpërndarjen e energjisë elektrike;
      ii. furnizimin e këtyre rrjeteve me energji elektrike.

   c) Uji, sipas përcaktimit në nenin 62, të LPP-së:

[67] Shtuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

i. ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t'i ofrojnë publikut shërbime për prodhimin, transportin ose shpërndarjen e ujit të pijshëm;
ii. furnizimin me ujë të pijshëm të këtyre rrjeteve.

Rregullat për prokurimin e kontratave sektoriale zbatohet edhe për kontratat ose konkurset e projektimit që jepen ose organizohen nga entet kontraktore që kryejnë një veprimtari që përmendet në nënndarjet "i" dhe "ii" dhe që janë të lidhura me një nga veprimtaritë e mëposhtme:

- projekte të inxhinierisë hidraulike, ujitjes ose drenazhimit të tokës, me kusht që vëllimi i ujit që do të përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të përbëjë më shumë se 20% të vëllimit të përgjithshëm të ujit të vënë në dispozicion nga këto projekte ose nga infrastruktura ujitëse ose drenazhuese;
- asgjësimin ose trajtimin e ujërave të zeza.

ç) Shërbimet e transportit, sipas përcaktimit në nenin 63, të LPP-së;

d) Portet dhe aeroportet, sipas përcaktimit në nenin 64, të LPP-së;

dh) Shërbimet postare, sipas përcaktimit në nenin 65, të LPP-së.

Sipas përcaktimit në shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 65, të LPP-së, shërbime postare janë dhe ato shërbime që kanë të bëjnë me zhdoganimin, klasifikimin, përcaktimin e itinerareve dhe dorëzimin e artikujve postarë. Kur enti kontraktor ofron shërbime postare, edhe shërbime të tjera që kanë lidhje me to janë të mbuluara nga rregullat për prokurimin e kontratave sektoriale.

e) Nxjerrja e naftës dhe e gazit dhe kërkimi ose nxjerrja e qymyrit ose lëndëve të tjera djegëse të ngurta, sipas përcaktimit në nenin 66, të LPP-së.

Si rregull, enti kontraktor do të zbatojë rregullat për prokurimin e kontratave sektoriale për të gjitha blerjet, për sa kohë që objekti që do të prokurohet do të përdoret vetëm për veprimtaritë e kontratave sektoriale.

2. Këtyre rregullave mund t'u nënshtrohen edhe entet private. Në këtë rast, enti privat duhet, detyrimisht, të kryejë veprimtari në sektorët e shërbimit ujor, energjetik, transportit dhe atij postar, sikurse është përcaktuar në LPP dhe në pikën 1, të këtij neni, mbi bazën e një të drejte të veçantë ose ekskluzive të lëshuar nga një autoritet kompetent i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet çdo klauzole legjislative, rregullatore apo administrative.

3. E drejtë e veçantë ose ekskluzive do të thotë një e drejtë që e kufizon të drejtën për kryerjen e veprimtarisë në fjalë, duke ua dhënë atë vetëm një apo më shumë shoqërive tregtare. Kjo e drejtë duhet ta vendosë entin në një pozicion monopoli ose oligopoli, në mënyrë që të mund t'ua kalojë kostot klientëve, meqenëse ata nuk do të kenë alternativë tjetër. Nëse një e drejtë e veçantë ose specifike mund të merret nga të gjitha entet që e kërkojnë atë, këto shoqëri tregtare nuk u nënshtrohen këtyre rregullave, pasi ato operojnë në një treg konkurrues.

4. Entet private, që kryejnë veprimtari në sektorët e shërbimit ujor, energjetik, transportit dhe atij postar pas fitimit të një kontrate prokurimi, nuk u nënshtrohen këtyre rregullave edhe në rastet kur ato përfundojnë në një pozicion monopolistik ose oligopolistik.

Neni 70
Kontratat e lidhura për qëllime të rishitjes apo dhënies me qira palëve të treta

Sipas parashikimit në nenin 67, të LPP-së, kontratat sektoriale të lidhura nga enti kontraktor për qëllime të rishitjes apo dhënies me qira palëve të treta, nuk mbulohen nga rregullat e prokurimit publik, nëse nuk ekziston një e drejtë e veçantë ose ekskluzive në lidhje me objektin e kontratës.

Kushti për përjashtim është që enti kontraktor në asnjë mënyrë nuk i përpunon produktet, por vetëm i blen dhe i shet ato, pa pasur ndonjë të drejtë ekskluzive.

Neni 71
Sipërmarrjet e lidhura

1. Sipërmarrjet e lidhura me entet kontraktore (në parim, shoqëria tregtare nënë, motër dhe nëndegë të shoqërisë tregtare) apo brenda një bashkimi operatorësh, për blerjen e mallrave, shërbimeve ose punëve, nuk janë të detyruara të prokurojnë sipas rregullave të këtij kreu.

2. Sipërmarrjet e lidhura, 80% të xhiros vjetore e realizojnë me furnizimin e mallrave/shërbimeve/punëve që prokurohen nga shoqëritë tregtare, me të cilat ajo është e lidhur dhe vetëm deri në 20% të mallrave/shërbimeve/punëve mund të tregtohet në tregun e hapur.

   Ky kufizim ka për qëllim parandalimin e konkurrimit të shoqërive tregtare të lidhura me shoqëri tregtare të tjera dhe për të shijuar përfitimet e të operuarit vetëm e pa konkurrencë për furnizimin e bizneseve me pozicion monopolistik ose oligopolistik.

Nëse më tepër se një shoqëri tregtare e lidhur me entin kontraktor ofron mallra/punë/shërbime të njëjta ose të ngjashme, është e domosdoshme të llogaritet duke iu referuar xhiros totale të të gjithave shoqërive tregtare të lidhura. Nëse xhiroja e krijuar nga tregtia me shoqëritë tregtare të jashtme e kalon vlerën 20%, përjashtimi nuk është i zbatueshëm.

3. Në mënyrë që të lehtësojnë bashkëpunimin në projektet madhore, entet kontraktore që operojnë në sektorët e shërbimeve utilitare mund të formojnë të ashtuquajturit bashkime operatorësh. Bashkimet e operatorëve mund të blejnë mallra /shërbime/punë nga njëri prej enteve kontraktore që janë partnerë, pa e shpallur kontratën për konkurrim.

   Kjo dispozitë aplikohet me kusht që entet kontraktore të kenë formuar bashkimin e operatorëve për një afat të paktën 3-vjeçar dhe ekskluzivisht për të kryer një veprimtari në sektorët e shërbimeve utilitare.

Neni 72
Sistemet e kualifikimit

1. Entet kontraktore në sektorët e shërbimeve utilitare mund të krijojnë dhe të zbatojnë një sistem kualifikimi, për parakualifikimin e operatorëve ekonomikë. Qëllimi i një sistemi kualifikimi është të kursejë kohë kur një ent kontraktor blen rregullisht disa mallra/shërbime/punime të caktuara.

   Sistemi i kualifikimit zëvendëson fazën e parë të një procedure të kufizuar ose me negociim dhe duhet të përmbajë kritere përzgjedhjeje që zakonisht u kërkohen operatorëve ekonomikë në fazën e parë të prokurimit. Kriteret e përzgjedhjes duhet të jenë të disponueshme për të gjithë operatorët e interesuar.

2. Të gjithë operatorët ekonomikë, që kërkojnë të marrin pjesë dhe që përmbushin kriteret e përzgjedhjes do të përfshihen në sistem. Aplikimet do t'i dorëzohen entit kontraktor, i cili duhet ta shqyrtojë aplikimin brenda gjashtë muajve.

   Një operator ekonomik, të cilit i janë refuzuar aplikimet, do të njoftohet për arsyet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e marrjes së vendimit.

   Një operator ekonomik që është pranuar në sistem mund të përjashtohet vetëm për arsye të publikuara paraprakisht në rregullat e kualifikimit për krijimin e sistemit.

3. Kur duhet të prokurohen mallra/shërbime, enti kontraktor mund t'i drejtohet drejtpërdrejt operatorit ekonomik në listë, pa pasur nevojë të shpallë një konkurrim të ri.

   Enti kontraktor nuk është i detyruar t´i drejtohet të gjithë operatorëve ekonomikë të përfshirë në listë, por duhet që gjithmonë të kërkojë oferta nga ata operatorë ekonomikë që kanë aftësinë për të përmbushur kontratën specifike dhe janë të kualifikuar në kategorinë respektive, kur sistemi i kualifikimit është ndarë në kategori sipas llojit të kontratës.

KREU IX
ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË AUTORITETIN/ENTIN KONTRAKTOR

Neni 73
Titullari i autoritetit/entit kontraktor

1. Titullari i autoritetit/entit kontraktor mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e autoritetit/entit kontraktor, të përcaktuar në nenin 21 të LPP-së dhe është përgjegjës për:

   - caktimin e personit/ave përgjegjës në fillim të vitit;
   - ngritjen e njësisë së prokurimit, komisioneve dhe/ose grupeve të punës, sipas rastit, të përfshira në procesin e prokurimit dhe zbatimin e kontratës[68];
   - nxjerrjen e urdhrit të prokurimit;
   - miratimin e raportit përmbledhës të procedurës së prokurimit dhe adresimin e çështjeve apo problematikave që mund të dalin nga ky raport.

2. Titullari i autoritetit/entit kontraktor mund t'ia delegojë kryerjen e detyrave në këtë cilësi, një zyrtari të autorizuar prej tij. Zyrtar i autorizuar duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit/entit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari, por kur nuk ka një të tillë, këtë rol e mban zyrtari me pozicionin më të lartë pas titullarit. Në këtë rast, zyrtari i autorizuar do të konsiderohet titullar për efekt të procesit të prokurimit.

3. Titullari i autoritetit/entit kontraktor duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit. Në çdo rast titullari i autoritetit/entit kontraktor duhet të sigurohet që zyrtarët/nëpunësit e prokurimit të jenë pjesë në vetëm një prej

[68] Shtuar me VKM 498/2024

grupeve të punës që do të merren me procesin e prokurimit deri në shpalljen e fituesit pas përfundimit të afateve të ankimit.[69]

4. Titullari i autoritetit/entit kontraktor duhet të marrë masa për shmangien e çdo konflikti interesi në marrëdhëniet e tij, punonjësve të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik, sikurse përcaktohet në nenin 19, të LPP-së.

   Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e çdo nëpunësi, të angazhuar në procesin e prokurimit. Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Nuk lejohet që titullari i autoritetit/entit kontraktor të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla.

   Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Neni 74
Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit

1. Titullari i autoritetit/entit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/personat përgjegjës për prokurimin dhe dërgon emrin/emrat respektivë, me kontaktet përkatëse, në Agjencinë e Prokurimit Publik.

   Personi/at përgjegjës duhet të jenë minimalisht me arsim të lartë. Autoritetet/entet kontraktore duhet të nxisin trajnimin e personit/personave përgjegjës në fushën e prokurimit publik.

   Personi/at përgjegjës për prokurimin duhet të administrojë/jnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit.

   Në varësi të numrit të procedurave të prokurimit të parashikuara për t'u zhvilluar, autoriteti/enti kontraktor mund të caktojë më shumë se një person përgjegjës për prokurimin.

[69] Shtuar me VKM 498/2024

2. Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor krijon njësinë e prokurimit.

   Në përbërje të njësisë së prokurimit është detyrimisht, personi përgjegjës për prokurimin, dhe të paktën një specialist fushe, në rast se kërkohen njohuri të specializuara për objektin e prokurimit.

   Në rastet kur autoriteti/enti kontraktor ka më shumë se një person përgjegjës, titullari i autoritetit ose entit kontraktor mund të vlerësojë përfshirjen e dy ose më shumë prej tyre, në njësinë e prokurimit.

   Në raste të tjera, titullari i autoritetit/entit kontraktor cakton në përbërjen e njësisë së prokurimit, përveç personit përgjegjës për prokurimin, një ose disa persona të tjerë, me arsim të lartë.

   Në çdo rast, numri i anëtarëve të njësisë së prokurimit duhet të jetë numër tek.

   Në rast mungese personeli, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete/ente të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm.

   Përveç sa më sipër, autoriteti/enti kontraktor mund të krijojë një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete/ente kontraktore.

3. Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme:

   a) Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;
   b) Përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin, kur është rasti) kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme;
   c) Hartimin e urdhrit të prokurimit;
   ç) Përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre;
   d) Hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;
   dh) Hartimin dhe dërgimin e ftesave për pjesëmarrje kandidatëve të ftuar në një procedurë prokurimi, nëse është rasti, duke argumentuar përzgjedhjen e tyre;
   e) Administrimin e të gjitha procesverbaleve për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;
   ë) Llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti;

f) Në kuadër të hartimit të dokumenteve të tenderit, bashkërendimin e punës me APP-në, me qëllim realizimin e kësaj detyre me efikasitet dhe në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi;
g) Ndjek procesin e komunikimit me operatorët ekonomikë, të përfshirë në procesin e ankimimit, për çdo vendim në procesin e shqyrtimit të ankesës, sipas parashikimeve në këto rregulla;
gj) Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti/enti kontraktor;
h) Ndjekjen e procedurave për konfiskimin e sigurimit të ofertës sipas përcaktimit në LPP dhe në këto rregulla;
i) Administrimin e sigurimit të kontratës përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor;
j) [70].

4. [71]Specialisti i fushës ose struktura e posaçme kryen detyrat e mëposhtme, sipas rastit:

- Hartimi i specifikimeve teknike;
- Përllogaritja e fondit limit;
- Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetin teknik;
- Hartimi i kritereve për shpalljen e ofertës fituese, nëse është rasti;
- Përcaktimi i çdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit (si p.sh., grafiku i lëvrimit).

Në rast se detyrat nuk janë kryer nga specialisti i fushës ose struktura e posaçme, ato do të kryhen nga njësia e prokurimit/komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, për objektin që prokurohet.

Neni 75
Komisioni i vlerësimit të ofertave

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit. Në rastin e prokurimit të kontratave të shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që

[70] Shfuqizuar me VKM 498/2024
[71] Ndryshuar me VKM 498/2024

kërkojnë ekspertizë të posacme, të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të jenë ekspertë të fushës së objektit që prokurohet.[72]

2. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

3. Një prej anëtarëve të komisionit caktohet kryetar dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit.

   Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë tek.

   Në rastin e mungesës së personelit, autoriteti/enti kontraktor mund të punësojë me kontratë ekspertë të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

4. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit.

   Në çdo rast, përgjegjësia për vlerësimin e ofertave është e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

   Përjashtimisht, nëse Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson dhe argumenton se një ose disa kritere janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit dhe/ose legjislacionin e fushës në fuqi, ka të drejtë t'i propozojë titullarit anulimin e procedurës.

   Anëtarët e komisionit nuk kryejnë asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla.

Neni 75/1[73]
Profesionalizimi i prokurimit publik

1. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, harton kurrikulat e trajnimit, organizon dhe zhvillon modulet e trajnimit në lidhje me prokurimin publik, me cilësi dhe profesionalizëm.
2. Kurrikulat e trajnimit për prokurimin publik organizohen në 4 nivele të njohurive, si më poshtë:
   a) Niveli bazë;
   b) Niveli mesatar;

[72] Shtuar me VKM 498/2024
[73] Shtuar me VKM 498/2024

c) Niveli i avancuar;
ç) Niveli ekspert.

3. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike është institucioni përgjegjës për organizimin e trajnimeve dhe testimeve në lidhje me prokurimin publik dhe pajisjen me certifikatën e trajnimit për nivelin përkatës.
4. Personat përgjegjës për prokurimin, si edhe personat e punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin, nëse ka, brenda një autoriteti/enti kontraktor kanë detyrimin të pajisen me certifikatën e njohurive në këtë fushë, të paktën në nivelin bazë, sipas parashikimeve në aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me përshkrimet e punës dhe procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë, për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të nxjerra në zbatim të ligjit për nëpunësin civil.

   Parashikimet e akteve të mësipërme janë të vlefshme edhe për personat përgjegjës për prokurimin apo personat e punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin në autoritete/ente kontraktore që nuk janë subjekt i legjislacionit për nëpunësin civil.
5. Autoriteti/enti kontraktor duhet t'i mundësojë personave përgjegjës dhe personave të punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin të marrin pjesë në trajnimin e detyrueshëm bazë në fushën e prokurimit publik dhe/ose dhënien e testimit për pajisjen me certifikatën njohurive.
6. Autoriteti /enti kontraktor e trajton kohën e shpenzuar nga personi përgjegjës apo punonjësi i përfshirë në procesin e prokurimit si orar të zakonshëm pune dhe e kompenson atë njëlloj sikurse ta kishte shpenzuar atë kohë në punë.
7. Kohëzgjatja e një kurrikule trajnimi është 40 (dyzet) orë.
8. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike mban Rregjistrin e Personave të certifikuar në fushën e prokurimit publik dhe një kopje të tij ia dërgon Agjencisë së Prokurimit Publik në mënyrë periodike ose sa herë që kërkohet nga kjo e fundit.
9. Personat përgjegjës ose personat e punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin, nëse ka, mund të vendosin të zhvillojnë trajnimin e detyrueshëm bazë ose të kryejnë direkt testimin për marrjen e certifikatës. Me kalimin me sukses të testimit të zhvilluar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, personi përgjegjës apo personi i punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin, pajiset me certifikatën përkatëse, që i përkon nivelit të certifikatës, sipas pikëve të marra në testim. Moskalimi me sukses i testimit nga ana e personit përgjegjës apo personit të punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin detyron këta të fundit që të

rikryejnë trajnimin e detyrueshëm bazë, në përfundim të të cilit duhet të kryhet përsëri testimi për marrjen e certifikatës.

10. Certifikata e trajnimit, pas kalimit me sukses të testimit përkatës nga personi përgjegjës apo personi i punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin, është e vlefshme për 5 (pesë) vjet. Në përfundim të afatit 5 vjeçar, personi përgjegjës apo personi i punësuar në struktura të dedikuara për prokurimin është i detyruar që të trajnohet/testohet lidhur me rinovimin e certifikatës apo për të kaluar në një nivel më të lartë certifikimi.
11. Personat, të cilët posedojnë një diplomë master ose doktoraturë në fushën e prokurimit publik, janë të përjashtuar nga detyrimi për certifikim nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, por regjistrohen automatikisht në Regjistrin e Personave të certifikuar me paraqitjen e diplomës, si më poshtë:
    a) Personat me diplomë master-nivel i avancuar;
    b) Personat me doktoraturë-nivel eksperti.
12. Punonjësit e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Komisionit të Prokurimit Publik, përveç punonjësve që punojnë në pozicione mbështetëse, janë të përjashtuar nga detyrimi për certifikim nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, por regjistrohen automatikisht në Regjistrin e Personave të certifikuar me paraqitjen e njoftimeve nga titullarët e institucioneve, si më poshtë vijon:
    a) Punojësit e sapopunësuar dhe deri 2 vjet eksperiencë pune- nivel bazë;
    b) Punonjësit me eksperiencë pune 2-5 vjet –nivel mesatar;
    c) Punonjësit me eksperiencë pune 5-7 vjet-nivel i avancuar;
    ç) Punonjësit me eksperiencë pune mbi 7 vjet-nivel eksperti.

Eksperiencë pune për punonjësit e cilësuar në këtë pikë do të konsiderohet si eksperienca në këto institucione, ashtu edhe në cdo institucion/sektor privat në fushën e prokurimit.

13. Në rast se personat e mësipërm dëshirojnë të kalojë në një nivel më të lartë certifikimi në fushën e prokurimit publik, mund të ndjekin trajnimin sipas kurrikulës përkatëse ose të hyjnë direkt në testim sipas kalendarit të testimeve të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.
14. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Agjencinë e Prokurimit Publik, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, harton rregulla procedurale të detajuara lidhur me organizimin e procesit, ku përcaktohen procedurat dhe

kriteret për oganizimin e trajnimeve, testimeve dhe dhënien e certifikatave në fushën e prokurimit publik.

KREU X
ZHVILLIMI I PROCEDURAVE

Neni 76
Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit

1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

   a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
   b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
   c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
   ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

   Autoriteti/enti kontraktor mund t´i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

3. Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

Neni 77
Urdhri i prokurimit

Urdhri i prokurimit" është akti administrativ i nxjerrë nga autoriteti ose enti kontraktor pas fazës përgatitore të procesit për prokurimin e një objekti të caktuar

dhe që konsiderohet momenti i fillimit të procedurës konkrete të prokurimit për objektin.[74]
Pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 76, të këtyre rregullave, titullari i autoritetit/entit kontraktor nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përllogaritur të vitit buxhetor, si dhe fondin total të përllogaritur, në rastin e kontratave shumëvjeçare dhe marrëveshjes kuadër;
- llojin e procedurës së prokurimit, arsyet e përdorimit të saj ose mënyrën e prokurimit (nëse është rasti);
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, duke evidentuar personin/at përgjegjës, dhe nëse është rasti edhe specialistin e fushës, sipas parashikimeve të nenit 74, të këtyre rregullave.

Neni 78
Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit

1. Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit, sipas llojit të procedurës e tipit të kontratës.

2. Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

   Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

   Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit.

3. Nëse gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, përpara publikimit të një procedure prokurimi, njësia e prokurimit ka nevojë për asistencë, komunikon

[74] Shtuar me VKM 498/2024

me APP-në, për të marrë një mendim të specializuar mbi mënyrën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik.

Me qëllim dhënien e asistencës, ngritjen e kapaciteteve dhe sigurimin e mirëzbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, APP, në koordinim me personin/at përgjegjës për prokurimin mund të asistojë këto të fundit gjatë përgatitjes të dokumenteve të tenderit në përputhje me dokumentet standarde të tenderit dhe rregullat e prokurimit publik.

Për efekt shpejtësie, komunikimi me APP-në për koordinimin e veprimtarisë gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit dhe marrjes së asistencës mund të bëhet me mjete elektronike (me *e-mail*).

Afatet dhe procedura e detajuar e koordinimit të veprimtarisë së njësive të prokurimit me APP-në, në funksion të marrjes së asistencës dhe ngritjes së kapaciteteve, rregullohen me udhëzim të APP-së.

4. Pas nënshkrimit të njoftimit të kontratës nga titullari i autoritetit kontraktor, personi/at përgjegjës për prokurimin dërgon/jnë dokumentet e tenderit dhe procesverbalin e argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike, termat e referencës [75]dhe kritereve për kualifikim, për publikim, në përputhje me nenet 55 e 56, të LPP-së.

5. Në procedurat e prokurimit me mjete elektronike, publikimi i njoftimit të kontratës, dokumenteve të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike, termat e referencës[76] dhe kritereve për kualifikim, do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

Neni 79
Dorëzimi i ofertave

1. Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e përcaktuar në dokumentet e tenderit brenda afatit kohor, të përcaktuar në këto dokumente si afati i fundit për dorëzimin e tyre.

   Në rastin e procedurave që zhvillohen në formë shkresore, çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në njoftimin e autoritetit/entit kontraktor nuk shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit të ofertave dhe i kthehet e pahapur kandidatit/ofertuesit.

[75] Shtuar me VKM 498/2024
[76] Shtuar me VKM 498/2024

Operatorët ekonomikë mund të jenë të pranishëm, nëse e kërkojnë, në procesin e hapjes së ofertave.

2. Në rastin procedurave të prokurimit me një fazë, ofertuesit dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar, duke përfshirë dhe ofertën ekonomike, në të njëjtën kohë.

   Kur procedura zhvillohet në formë shkresore, ky dokumentacion duhet të paraqitet në një zarf të mbyllur, me vulën e shoqërisë.

3. Në rastin e procedurave të prokurimit me faza, në fazën e parë të kualifikimit, dokumentacioni duhet të përmbajë vetëm dokumentet e kualifikimit, siç parashikohet në dokumentet e tenderit. Në fazën e dytë e në vijim, operatori ekonomik duhet të dorëzojë ofertën teknike dhe ofertën ekonomike.

   Kur procedura zhvillohet në formë shkresore, në secilën fazë, dokumentet e kualifikimit, oferta teknike dhe ajo ekonomike duhet të paraqiten respektivisht në zarfe të mbyllura, me vulën e shoqërisë.

   Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, dorëzimi i ofertave të operatorëve do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vetëm një ofertë, me përjashtim të rasteve kur kërkohen oferta alternative.

Neni 80
Hapja e ofertave

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave hap dhe lexon ofertat në përputhje me nenin 90 të LPP dhe me përcaktimet në këto rregulla.

2. Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë, përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës.

   Nëse evidentohet se një ose disa prej operatorëve ekonomikë ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose disa prej zyrtarëve të caktuar për vlerësimin e ofertave, atëherë duhet të zëvendësohet zyrtari/zyrtarët në fjalë dhe më pas të vazhdojë procesi i prokurimit.

3. Personi përgjegjës për prokurimin, anëtar i njësisë së prokurimit, mund të jetë i pranishëm gjatë fazës së hapjes së ofertave duke kryer funksione të karakterit ndihmës, si mbajtja e procesverbalit, sistemimi dhe ruajtja e dokumenteve.

4. Në rastin kur, procedura zhvillohet në formë shkresore, komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin dhe adresën e ofertuesit dhe hap zarfin përkatës. Më pas lexohet me zë të lartë oferta ekonomike dhe lista e dokumenteve ligjore, administrative dhe kualifikuese të paraqitura nga ofertuesi. Procesverbali dhe një vërtetim, që pasqyron të gjitha dokumentet, që shoqërojnë ofertën e tij duhet t'i vihet në dispozicion në bazë të kërkesës çdo ofertuesi, ndërsa ofertuesve që kanë paraqitur ofertë, por që nuk janë të pranishëm ose të përfaqësuar në hapjen e ofertave, duhet t'u dërgohet njoftim për hapjen e procedurës.

   Oferta ekonomike nënshkruhet në pjesën e pasme të fletës nga të gjithë anëtarët e komisionit.

   Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbal. Personi përgjegjës për prokurimin, anëtar i njësisë së prokurimit është përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe teksti përfundimtar i tij duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

5. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të dokumentohet.

6. Dokumentet që shoqërojnë ofertën nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen, në përputhje me nenin 21, të LPP-së.

Neni 81
Ndërhyrja në ofertë

1. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.

2. Ndërhyrje në ofertë do të konsiderohet edhe pjesëmarrja e dy ose më shumë ofertuesve me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedurë prokurimi.

3. Autoriteti/enti kontraktor vlerëson rast pas rasti nëse konstaton të dhëna të tilla, që mund të shërbejnë si tregues për ndërhyrje në oferta nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues.

Neni 82

Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuara ndryshe në këto rregulla.

   Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

   Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

   i. "Devijimi" është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;
   ii. "Rezervimi" është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe
   iii. "Mospranimi" është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

   Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

   a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë

mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin[77].

b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.[78]

c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përllogaritjen e zërave të ofertës[79].

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

[80]Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave

[77] Shtuar me VKM 498/2024
[78] Shtuar me VKM 498/2024
[79] Ndryshuar me VKM 498/2024
[80] Ndryshuar me VKM 498/2024

duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:
O - Oferta
MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme
N - Numri i ofertave të vlefshme
PR (Zm) – Zbritje e mundshme
MO = O1 + O2 + O3 + … On / N
PR = 85 % Mo
Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR .....rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

5. Në rastin e procedurave të prokurimit me faza, komisioni i vlerësimit të ofertave lexon emrin dhe adresën e kandidatit dhe listën e të gjitha dokumenteve të kualifikimit, të paraqitura prej tij. Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 10 (dhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, nga data e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar, komisioni i vlerësimit përcakton listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar, që do të vlerësohen për ofertën dhe ia komunikon këtë informacion menjëherë të gjithë kandidatëve, që kanë paraqitur kërkesë për pjesëmarrje. Kandidatëve të kualifikuar, në përfundim të afateve të ankimit, u dërgohet një ftesë për ofertë, në përputhje me nenin 58, të LPP-së.

   Më pas, komisioni i vlerësimit të ofertave vazhdon vlerësimin e ofertave teknike të kandidatëve të kualifikuar dhe bën klasifikimin teknik.

   Në varësi të llojit të procedurës së prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, në varësi të kompleksitetit të kontratës, mund të zhvillojë negociata në faza të ndryshme me secilin nga kandidatët e përzgjedhur, por gjithmonë duhet të pasqyrojë përmbajtjen e tyre në procesverbalin përkatës.

   Komisioni i vlerësimit të ofertave kalon në shqyrtimin e ofertës ekonomike dhe verifikon nëse ka gabime aritmetike apo çmim anomalisht të ulët, sipas përcaktimeve në pikat 3 dhe 4, të këtij neni.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbal.

Në bazë të ofertave të pranuara, komisioni i vlerësimit të ofertave merr vendim për shpalljen e fituesit, i cili publikohet në sistemin e prokurimit elektronik menjëherë, por jo më vonë se 7 (shtatë) ditë[81] pas përfundimit të procedurës së vlerësimit.

Në rastin e procedurave me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, afatet për vlerësimin e ofertave përcaktohen nga autoriteti kontraktor, në varësi të kompleksitetit të kontratës dhe situatës konkrete.

6. Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Njoftimi për datën dhe orën e hedhjes së shortit u njoftohet ofertuesve. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim.

Neni 83
Njoftimi i fituesit

1. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor bën klasifikimin përfundimtar dhe harton njoftimin e fituesit.

2. Jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimin e fituesit, në përputhje me nenin 97, të LPP-së, pas publikimit të të cilit nisin afatet e ankimit[82].

3. Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në formë shkresore, autoriteti/enti kontraktor publikon njoftimin e fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Neni 84
Raporti përmbledhës

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit/entit kontraktor.

[81] Ndryshuar me Vkm 498/2024

[82] Ndryshuar me Vkm 498/2024

2. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë:

- objektin e prokurimit;
- përshkrimin e punëve/ mallrave/shërbimeve;
- respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave;
- çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës;
- korrigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla);
- të dhënat e ofertuesve të skualifikuar, ofertën ekonomike dhe arsyet e skualifikimit;
- të dhënat e ofertuesve të kualifikuar, ofertën ekonomike të tyre;
- informacion për hedhjen e shortit (nëse ka pasur oferta me vlerë të njëjtë);
- të dhënat e ofertuesit fitues;
- informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave.

Neni 85
Lidhja e kontratës

1. Autoriteti/enti kontraktor do të ftojë operatorin ekonomik të shpallur fitues, që të lidhë kontratën menjëherë pas përfundimit të afateve të ankimit ose dhënies së një vendimi përfundimtar për ankesën, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga kjo datë.

   Operatori ekonomik i shpallur fitues është i detyruar t'i përgjigjet kërkesës së autoritetit/entit kontraktor për lidhjen e kontratës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

2. Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.

Neni 86
Publikimi i njoftimit të lidhjes së kontratës

Pas nënshkrimit të kontratës, brenda 5 (pesë) ditëve, autoriteti/enti kontraktor dërgon për publikim në sistemin e prokurimit elektronik dhe/ose Buletinin e Njoftimeve Publike njoftimin e kontratës së nënshkruar.

Neni 87
Mënyra e zhvillimit të procedurave me mjete elektronike

Mënyra e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

KREU XI
KUSHTE TË PËRGJITHSHME PËR ZBATIM

Neni 88
Bashkimi i operatorëve ekonomikë

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

   Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

4. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti

kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.

4.1. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, në prokurimin e kontratave të shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, këto të fundit nuk kanë detyrimin e deklarimit të përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim. Secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.[83]

5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

6. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.

Neni 89
Nënkontraktimi

1. Autoriteti/enti kontraktor mund të lejojë nënkontraktimin për realizimin e një pjese të kontratës sipas përcaktimit në nenin 126, të LPP-së. Në asnjë rast, kontraktorët nuk mund t'ua transferojnë kontratën palëve të treta. Autoriteti/enti kontraktor lejon në veçanti nënkontraktimin për të nxitur pjesëmarrjen e operatorëve të vegjël e të mesëm ekonomikë.

2. Në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohet qartë nëse lejohet ose jo nënkontraktimi, si dhe nëse autoriteti/enti kontraktor do t'i bëjë pagesa të drejtpërdrejta nënkontraktorit.

3. Në asnjë rast nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 50% të vlerës së kontratës.

4. Me dorëzimin e ofertave, ofertuesit duhet të deklarojnë punët/shërbimet/mallrat ose një pjesë të tyre që ata kanë qëllim të nënkontraktojnë, në rast se shpallen fitues, si dhe emrin e nënkontraktorit.

[83] Shtuar me VKM 498/2024

5. Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit/entit kontraktor një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit.

   Nënkontraktori duhet të plotësojë kërkesat e nenit 76, të LPP-së, dhe të plotësojë kriteret e kualifikimit për pjesën e punës/shërbimit/mallrave që merr përsipër të furnizojë. Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson nëse nënkontraktori plotëson këto kërkesa, në mënyrë që autoriteti/enti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin.

6. Në rast të mosplotësimit nga nënkontraktori, të kritereve të kërkuara, autoriteti/enti kontraktor vijon me lidhjen e kontratës vetëm me operatorin ekonomik të shpallur fitues.

7. Në rastet kur nënkontraktori miratohet nga autoriteti/enti kontraktor, pjesë e kontratës duhet të jenë dhe detyrimet e marra përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori.

8. Gjatë ekzekutimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet të kontrollojë nëse pjesa e kontratës, e marrë përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori, po realizohet nga ky i fundit. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se, nënkontraktori nuk po realizon pjesën e kontratës së marrë përsipër, i kërkon kontraktorit kryesor të ndërpresë nënkontraktimin dhe të vijojë me zbatimin e kontratës.

9. Autoriteti/enti kontraktor lejohet të bëjë pagesa drejtpërsëdrejti tek nënkontraktori për furnizimet, shërbimet, ose punët që i ka ofruar kontraktorit kryesor, kur një gjë e tillë është përcaktuar në dokumentet e tenderit.

   Në çdo rast, kontraktori kryesor duhet të vihet në dijeni dhe të japë miratimin me shkrim për këto pagesa, të cilat janë të lidhura me faturat e pranuara nga autoriteti/enti kontraktor për llogari të ofertuesit kryesor.

Neni 90
Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

   - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;
   - t´i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
   - t´i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.
   - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.

   Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.

Neni 91
Ulja e numrit të kandidatëve të kualifikuar që do të ftohen

1. Në procedurat e prokurimit me faza, autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve që do të ftojë për të dhënë ofertë ose për të kryer një dialog, pavarësisht numrit të kandidatëve që përmbushin kriteret e përzgjedhjes, nëse një gjë e tillë ka qenë e parashikuar dhe publikuar në dokumentet e tenderit.

2. Autoriteti/enti kontraktor, në çdo rast, duhet të argumentojë arsyen e aplikimit të mundësisë së uljes së numrit numrit të operatorëve të kualifikuar që do të ftohen. Rastet kur ky kufizim mund të përdoret janë:

   - Numri i operatorëve në treg, që mund të kualifikohen është shumë i lartë;
   - Operatorët e kualifikuar do të kenë akses në dokumente me informacion konfidencial, të cilin autoriteti/enti kontraktor nuk mund ta shpërndajë tek shumë operatorë.

3. Për qëllim të zbatimit të nenit 85, të LPP-së, autoriteti/enti kontraktor duhet të ketë publikuar paraprakisht informacionin, si më poshtë vijon:

   a) Kriteret ose rregullat objektive dhe jodiskriminuese që do të zbatohen për uljen e numrit, të cilat duhet të jenë të lidhura me vlerësimin e ofertës ekonomikisht të favorshme (p.sh. kandidatët e kualifikuar me numrin më të lartë të pikëve do të ftohen).

   b) Numrin minimal të kandidatëve që synojnë të ftojnë, i cili, në çdo rast, nuk mund të jetë më pak se 5 (pesë) në procedurën e kufizuar dhe 3 (tre) në procedurën konkurruese me negociim, dialogun konkurrues dhe në partneritetin për inovacion. Në rastin e kontratave sektoriale, është e drejtë e entit kontraktor të përcaktojë numrin minimal të lejuar të kandidatëve, por jo më pak se 2 (dy).

      Pavarësisht numrit të përcaktuar sipas kësaj pike, nëse numri i kandidatëve që përmbushin kriteret e përzgjedhjes është nën numrin minimal të lejuar, autoriteti ose enti kontraktor mund të vazhdojë procedurën, duke ftuar vetëm kandidatët e kualifikuar.

   c) Numrin maksimal të kandidatëve, që synojnë të ftojnë.

Neni 92
Ulja e numrit të ofertave dhe zgjidhjeve

1. Në procedurat e prokurimit me faza, autoriteti/enti kontraktor, në fazën përfundimtare, mund të kufizojë numrin e ofertave dhe zgjidhjeve, nëse një gjë e tillë ka qenë e parashikuar dhe publikuar në dokumentet e tenderit.

2. Autoriteti/enti kontraktor, në çdo rast, duhet të argumentojë arsyen e aplikimit të mundësisë së uljes së numrit të ofertave dhe zgjidhjeve.

3. Autoriteti/enti kontraktor nuk mund të vendosë të përcaktojë numrin minimal të ofertave dhe zgjidhjeve në më pak se dy.

   Në çdo rast, numri i zvogëluar i ofertave ose i zgjidhjeve duhet të sigurojë konkurrencë të drejtë në fazën përfundimtare të negociatave ose dialogut.

Neni 93
Sigurimi i konkurrencës

1. Autoriteti/enti kontraktor duhet të marrë masa të sigurojë pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë dhe konkurrencë të drejtë në procedurat e prokurimit.

2. Në rast mungese të sigurimit të konkurrencës, autoriteti/enti kontraktor anulon procedurën, si më poshtë vijon:

   a) në procedurat me faza:

      i. në fazën e parë nuk është dorëzuar asnjë kërkesë për pjesëmarrje e përshtatshme;
      ii. në fazën e dytë nuk është asnjë ofertë e vlefshme.

   b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.

3. Autoriteti/enti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që çuan në dështimin e procedurës dhe, nëse është rasti, i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës.

   Ky proces dokumentohet në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim, nga njësia e prokurimit.

KREU XII
ANKIMI ADMINISTRATIV

Neni 94
Paraqitja e ankesave

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm [84]në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

2. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike[85].

3. Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkeljes së pretenduar.

   Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës për llogari buxhetit të shtetit. Dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën duhet t'i bashkëlidhet ankimit, që ankimuesi do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet[86].

4. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementeve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin.

   Njoftimi bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike[87].

   Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me veprimet e mësipërme, për korrigjimin e të metave të ankesës.

5. Ankesa duhet të korigjohet dhe paraqitet në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi.

---

[84] Shtuar me VKM 498/2024

[85] Ndryshuar me VKM 498/2024

[86] Ndryshuar me VKM 498/2024

[87] Ndryshuar me VKM 498/2024

Nëse ankesa nuk korrigjohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

Nëse afati i fundit bie gjatë ditëve të pushimit zyrtar, atëherë afati i fundit për plotësimin e ankesës do të jetë ditën pasardhëse të punës.

6. Formulari standard i ankesës hartohet nga APP-ja, në bashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik, dhe është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.

Neni 95
Veprimet paraprake të Komisionit të Prokurimit Publik

1. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këto rregulla e publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;
b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

Në mënyrë që, ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit;
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;
c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime[88].

2. Veprimet, sipas shkronjave "c", "ç" dhe "d", të pikës 1, të këtij neni, bëhen jo më vonë se dita pasardhëse e punës.

Neni 96
Veprimet paraprake të autoritetit/entit kontraktor

[88] Ndryshuar me VKM 498/2024

1. Me marrjen e ankesës [89]nga ankimuesi, personi përgjegjës për prokurimin konfirmon në bazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, nëse ankesa është paraqitur edhe pranë KPP-së.

   Në rast se, ankesa rezulton e publikuar, titullari i autoritetit/entit kontraktor urdhëron njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave të pezullojnë vazhdimin e procedurës, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, sipas parashikimeve të LPP-së.

   Veprimet dhe vendimet e autoritetit/entit kontraktor, sipas kësaj pike, bëhen jo më vonë se dita pasardhëse e punës.

   Autoriteti/enti kontraktor duhet të vijojë të verifikojë bazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik përgjatë afatit 10 (dhjetë) ditor.

   Procesi i pezullimit në sistemin e prokurimit elektronik, bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.

2. Në rast se ankesa është paraqitur pranë autoritetit/entit kontraktor, por ende nuk është publikuar nga KPP-ja, autoriteti/enti kontraktor do të cilësojë si datë të fillimit të afateve procedurale, datën e publikimit të ankesës në bazën e të dhënave të KPP-së.

3. Nëse autoriteti/enti kontraktor konstaton se, ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me nenin 110, të LPP-së, e refuzon atë, si të pavlefshme.

Neni 97
Afatet për paraqitjen e ankesave

1. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

   a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
   b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

[89] Hequr "me shkrim" me VKM 468/2024

2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

   a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anullimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
   b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

3. Në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, në procedurat e prokurimit me faza, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/ entit kontraktor:

   a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
   b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

4. Në rastin e ankesave për lidhjen e një kontrate në bazë të një marrëveshjeje kuadër, me disa operatorë ekonomikë, pas procedurave për rihapjen e konkurrimit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

   a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
   b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatese.[90]

Neni 98
Afate për ankime të veçanta

1. Në rastin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit.

   Nëse është publikuar njoftimi vullnetar për transparencë, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, sa i takon plotësimit të kushteve për

[90] Shtuar me VKM 498/2024

përdorimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe përmbajtjes së dokumenteve të tenderit.

2. Në rastin e konstatimit të një kontrate publike të lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP dhe/ose në rastin kur nuk është publikuar njoftimi i fituesit ose njoftimi i kontratës së nënshkruar, afati për paraqitjen e një ankese lidhur me këtë kontratë është 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga dita e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 99
Paraqitja e argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar

1. Për ankesat për vendimet e autoritetit/entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me ankesën, njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ne sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Paraqitja e argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar bëhet sipas një formulari standard, i cili hartohet nga APP-ja, në bashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik, dhe është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.

3.[91] Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e argumenteve, sipas pikës 1, të këtij neni, është 7 (shtatë) ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik.

   Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, ky afat është 5 (pesë) ditë.

4. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar, nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të kësaj pike, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë lidhur me ankesën për këtë procedurë prokurimi.

Neni 100
Afatet e shqyrtimit të ankesave nga autoriteti/enti kontraktor

[91] Ndryshuar me VKM 545/2024

1. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.

2. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti/enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur, brenda 5 (pesë) ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

   Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113, të LPP-së, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

3. Në rastin kur, për shqyrtimin e ankesës, autoriteti/enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, ndërpritet, dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar, afati nuk duhet të tejkalojë 30 (tridhjetë) ditë.

   Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

4. Autoriteti/enti kontraktor merr vendim, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 114, të LPP-së, dhe vë në dijeni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5.[92] Kundër vendimit të autoritetit/entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4, të këtij neni.

Neni 101
Hapat për shqyrtimin e ankesave në autoritetin/entin kontraktor

[92] Ndryshuar me VKM 545/2024

Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti/enti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:

1. Titullari i autoritetit/entit kontraktor, me urdhër të veçantë, cakton një person ose ngre një komision të përbërë nga të paktën 3 (tre) persona për shqyrtimin e ankesës.

   Të paktën njëri nga anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesës duhet të jetë ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim.

   Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit për të cilin është paraqitur ankesa.

   [93]

2. Personi përgjegjës për prokurimin duhet të kujdeset që të njoftojë ankimuesit dhe operatorët ekonomikë të interesuar, të përfshirë në proces për çdo vendim në procesin e shqyrtimit të ankesës edhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tyre në formularin e ankesës, jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së çdo vendimi.

3. Në rastin kur ankesa është pranuar plotësisht dhe nuk ka pasur argumente nga operatorët ekonomikë të interesuar, titullari i autoritetit/entit kontraktor njofton Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me këtë vendimmarrje dhe adreson zbatimin pas marrjes së vendimit deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.

4. Në rastet kur afatet kohore të procedurës së prokurimit, për të cilat janë njoftuar ofertuesit, ndryshojnë për shkak të marrjes parasysh të ankesës, autoriteti/enti kontraktor u shpërndan ofertuesve një njoftim të posaçëm, ku jepen arsyet për zgjatjen e këtyre afateve.

Neni 102
Vendimet e autoritetit/entit kontraktor në përfundim të shqyrtimit të ankesave

1. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, sipas parashikimeve në këto rregulla, autoriteti/enti kontraktor, mund të vendosë:

   a) pranimin e plotë të ankesës;
   b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
   c) refuzimin e ankesës.

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

3. Vendimi i autoritetit/entit kontraktor u komunikohet të gjitha subjekteve të përfshira në proces.

Neni 103
Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik

1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin/entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit, nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin/entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

   a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 110[93] dhe 111, të LPP-së;
   b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin/entin kontraktor të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;
   c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin/entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;
   ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3, të nenit 115, të LPP-së;
   d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.

   Në çdo rast, vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik duhet të merren në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 5, të nenit 115, të LPP-së.

   Në kuadër të shqyrtimit të një ankese, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta ose të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, por nuk mund të pezullojë vendimmarrjen dhe t'u kërkojë organeve të tjera kryerjen e procedimeve administrative për çështjen në

[93] Shtuar me VKM 498/2024

[93] Shfuqizuar me VKM 498/2024

fjalë.

3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit/entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e LPP-së, ka të drejtë:

   a) të deklarojë të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e LPP-së;
   b) të shkurtojë kohëzgjatjen e kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj;
   c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme, si rezultat i shkeljes së ligjit.

Neni 104
Ankesat për prokurimet me vlerë të vogël

1. Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, operatorët ekonomikë të refuzuar ose të renditur deri në vend të dhjetë, sipas përcaktimeve në nenin 56, të këtyre rregullave, kanë të drejtën të ankohen vetëm në autoritetin/entin kontraktor.

   Ankesat mund të bëhen për kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë ose për procesin e vlerësimit të ofertave.

2. Operatori/ operatorët ekonomikë, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij neni, të cilët kanë pretendime për procedurën e prokurimit, mund të paraqesin ankesë me shkrim brenda 2 (dy) ditëve nga konfirmimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik.

3. Titullari i autoritetit/entit kontraktor cakton me detyrën e shqyrtimit të ankesave një person që nuk ka qenë më parë i përfshirë në procedurën respektive.

4. Me marrjen e ankesës, autoriteti/enti kontraktor pezullon vijimin e procedurës së prokurimit, deri në shqyrtimin e plotë të ankesës.

5. Personi i ngarkuar me shqyrtimin e ankesës duhet të shprehet me vendim për pranimin ose refuzimin e ankesës, brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e ankesës.

6. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këto rregulla, autoriteti/enti kontraktor, mund të vendosë:

a) pranimin e plotë të ankesës;
b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
c) refuzimin e ankesës.

Vendimi i dhënë nga autoriteti/enti kontraktor i komunikohet menjëherë edhe në rrugë elektronike ankuesit/ankuesve.

Kundër vendimit të autoritetit/entit kontraktor, operatori ekonomik ka të drejtë të ankohet në gjykatën përkatëse që shqyrton mosmarrëveshjet administrative.

7. Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurën, lidhjen e kontratës apo ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.

Neni 105
Tërheqja e ankimit

Operatori ekonomik ankimues ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar, në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Me paraqitjen e kërkesës për tërheqje, ndërpritet shqyrtimi i ankesës menjëherë. Për efekt të tarifës, ankesa konsiderohet si e mospranuar, dhe tarifa e ankesës nuk kthehet.

KREU XIII
EKZEKUTIMI DHE MBIKËQYRJA E KONTRATËS

Neni 106
Kohëzgjatja e kontratës

1. Autoriteti/enti kontraktor për fondet buxhetore prokuron kontrata bazuar në fondin e një viti buxhetor.

2. Autoriteti/enti kontraktor mund të lidhë kontrata shumëvjeçare vetëm në rrethana të argumentuara, të shpallura në njoftimin e kontratës, që lidhen ngushtësisht me natyrën, kompleksitetin dhe financimin e saj, autoriteti/enti kontraktor mund të lidhë një kontratë shumëvjeçare, nëse:

   a) objekti i tyre është blerja, qiraja ose blerja me këste e mallrave, me ose pa mundësinë e kalimit të pronësisë, shërbimeve, që zgjat deri në pagimin e plotë të vlerës ose derisa pronësia t'i kalojë autoritetit kontraktor;
   b) është kontratë komplekse, që kërkon financim shumëvjeçar ose të strukturuar, e cila nuk mund të zbatohet brenda vitit buxhetor (si për

shembull, projektet komplekse në infrastrukturë) dhe ku financimi i saj është i garantuar.

3. Autoriteti/enti kontraktor nuk lidh kontrata shumëvjeçare për punë, mallra ose shërbime, për të cilat bëhen planifikim dhe përdorime vjetore, që gjenden lehtësisht në treg dhe mund të prokurohen normalisht.

4. Në çdo rast, financimi i kontratave të prokurimit bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

Neni 107
Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës

1. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore të autorizuara me ligj mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi.

2. Autoriteti/enti kontraktor, gjatë hartimit të kontratës, mund të caktojë kushte të veçanta për zbatimin e kontratës, për aq kohë sa ato janë të ligjshme dhe nuk vijnë në kundërshtim me dokumentet e tenderit. Këto kushte mund të përfshijnë faktorë ekonomikë, ato që lidhen me inovacionin, faktorë mjedisorë, socialë, ose që lidhen me punësimin. Këto kushte nuk duhet të rëndojnë ose të favorizojnë operatorin ekonomik fitues, ato duhet të jenë në përputhje me objektin e kontratës.

3. Për t'u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë, për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti/enti kontraktor për kontratat e lidhura në përfundim të procedurave me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlerë të vogël, të cilat kanë kohëzgjatje jo më pak se 6 muaj duhet të monitorojë zbatimin e kontratës sipas një plani zbatimi[94]. Autoriteti/enti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

4. Plani i zbatimit të kontratës përfshin në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. Plani duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor dhe operatori ekonomik, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës.[95]

[96]

[94] Ndryshuar me VKM 498/2024
[95] Ndryshuar me VKM 498/2024
[96] Shfuqizuar paragrafi me VKM 498/2024

Pas çdo modifikimi që mund t'i bëhet kontratës, plani përditësohet brenda 10 (dhjetë) ditëve[97] nga hartimi dhe nënshkrimi i modifikimit nga palët.
[98]

5. [99]

6. Komisioni i ngritur nga titullari i autoritetit/entit kontraktor sipas legjislacionit të fushës në fuqi është struktura përgjegjëse për ndjekjen me përpikmëri të ecurisë së zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës, në përputhje me kushtet e prokuruara dhe me legjislacionin në fuqi.

Struktura përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të kontratës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka këto përgjegjësi:

a) Harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;
b) Kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë;
c) Administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
ç) Sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë, dhe afateve, kur është rasti;
d) Menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/modifikime/përshtatje të saj;
dh) Raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për problematikat e hasura apo për shkelje të dispozitave kontraktuale, duke propozuar edhe masat konkrete;
e) Administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
ë) Mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
f) Përgatit formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, i cili pasi miratohet nga titullari, i përcillet APP-së.

Titullari i autoritetit/entit kontraktor, pa cënuar detyrimet që lindin nga legjislacioni i fushës, mund të ngarkojë në urdhrin përkatës një ose disa nga

[97] Ndryshuar me VKM 498/2024
[98] Shfuqizuar paragrafi me VKM 498/2024
[99] Shfuqizuar pika 5 me VKM 498/2024

anëtarët e strukturës përgjegjëse për ndjekjen e zbatimit të kontratës, për kryerjen e detyrave të veçanta, sipas shkronjave të mësipërme[100].

7. Në përfundim të kontratës, struktura e ngarkuar për ndjekjen e kontratës përgatit formularin e raportimit për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, duke pasqyruar në të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të kontratës, modifikimet e kryera në kontratë, nëse është rasti, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, sipas rastit, si dhe informacion për likujdimin ose jo të kontratës. Për çdo situatë të raportuar në lidhje me ecurinë e zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor pasqyron në formularin e raportimit rrethanat, arsyet dhe argumentimin përkatës mbi bazën e dispozitave ligjore, që bazohet situata konkrete në zbatimin e kontratës[101].

8. Formularët e planit të zbatimit të kontratës dhe raportimit për zbatimin e kontratës, sipas parashikimeve të këtij neni, do të jenë në përputhje me udhëzimet e APP-së[102].

9. Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gasoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e normës së fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet/entet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, të lëshuara sipas legjislacionit tatimor në fuqi në lidhje me momentin e leshimit të faturës, mbështetur në çmimin e bursës në ditën para lëshimit të faturës, të publikuar nga APP pas dërgimit të këtij çmimi për publikim[103] nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, levruar sipas kushtit CIF-Shqipëri dhe të konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të ditës para lëshimit të faturës[104].

10. Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, të publikuar nga APP pas dërgimit të këtij çmimi për publikim[105], nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shitjes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e

[100] Ndryshuar me VKM 498/2024

[101] Ndryshuar me VKM 498/2024

[102] Ndryshuar me VKM 498/2024

[103] Ndryshuar me VKM 545/2024

[104] Ndryshuar me VKM 498/2024

[105] Ndryshuar me VKM 498/2024

mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë të cilën është shpallur fitues kontraktori.[106]

Neni 108[107]

KREU XIV
HETIMI ADMINISTRATIV NGA AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Neni 109
Rastet për kryerjen e hetimit administrativ

1. Agjencia e Prokurimit Publik kryen hetim administrativ, në përputhje me parashikimet e nenit 129, të LPP-së, si më poshtë vijon:

   a) për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në kryerjen e procedurave të prokurimit publik, pasi ka përfunduar procedura me nënshkrimin e kontratës së prokurimit, por, në çdo rast, jo më vonë se 3 (tre) vjet nga nënshkrimi i saj;
   b) për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në kryerjen e procedurave të prokurimit edhe nëse këto procedura janë anuluar, por, në çdo rast, jo më vonë se 3 (tre) vjet nga anulimi i tyre;
   c) për përjashtimin e një operatori ekonomik nga fitimi i kontratave publike, në çdo rast, jo më vonë se 3 (tre) vjet nga shkaktimi i situatës, për të cilën kërkohet përjashtimi;
   ç) për monitorimin e zbatimit të kontratës së nënshkruar bazuar në dokumentacionin e administruar nga autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i nënshkrimit të kontratës dhe jo më vonë se 3 (tre) vjet nga përfundimi i zbatimit të saj[108].

Neni 110
Procedura hetimore në procesin e përjashtimit të operatorëve ekonomikë

1. APP-ja përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, për një periudhë nga 3 (tre) muaj deri në 3 (tre) vjet, në rastet e përcaktuara në nenin 78, të LPP-së.

---

[106] Shtuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021
[107] Shfuqizuar neni 108 me VKM 498/2024
[108] Ndryshuar me VKM 498/2024

2. Procedimi administrativ ndaj një operatori ekonomik mund të iniciohet në bazë të kërkesave nga të tretët, të argumentuara dhe mbështetura në prova dokumentare ose gjatë verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë së procedurave apo monitorimit të kontratave, nga vetë APP-së.

3. Çdo kërkesë e paraqitur në APP nga të tretët duhet të jetë e nënshkruar dhe e shoqëruar me dokumentacionin provues.
   Në rast se, kërkesa e paraqitur nuk është e nënshkruar dhe shoqëruar me dokumentacionin provues, dërguesit i kthehet mbrapsht për plotësim[109].

   Kur dokumentacioni i paraqitur sipas kësaj pike nuk është i plotë, APP-ja e kthen për plotësim pranë kërkuesit që ka nisur kërkesën. Nëse kërkesa nuk plotësohet, ajo do të konsiderohet e paparaqitur.

   APP-ja, pasi vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues, kur është e nevojshme, i kërkon autoritetit/entit kontraktor përkatës të bëjë verifikimet pranë institucioneve kompetente dhe të dërgojë në APP informacion për rezultatet e këtyre verifikimeve.

4. APP-ja ka të drejtë të bëjë verifikim të informacionit apo dokumenteve të paraqitura pranë saj për këtë qëllim në çdo fazë të procesit.

5. Procedura e hetimit administrativ nga APP-ja kryhet në përputhje me përcaktimet e nenit 129, të LPP-së dhe Kodit të Procedurave Administrative.

6. APP-ja merr vendim:

   a) për përjashtimin e operatorit ekonomik, kur provohet se plotësohen kushtet e përcaktuara në LPP;
   b) të mbyllë procedimin administrativ, duke mos përjashtuar operatorin ekonomik, kur nuk provohen kushtet e përcaktuara në LPP.

7. Kur përjashtimi i operatorit ekonomik vjen si pasojë e një vendimi të formës së prerë të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës për marrëveshje në oferta, APP-ja procedon direkt me marrjen e një vendimi përjashtimi dhe njofton operatorin ekonomik.

8. Në dhënien e një vendimi, APP-ja duhet të mbajë në konsideratë të paktën elementet, si më poshtë vijon:

[109] Ndryshuar me VKM 498/2024

a) vlerën e përllogaritur të fondit limit/kontratës;
b) faktin nëse operatori ka fituar fonde publike;
c) rrethanat e kryerjes së shkeljes;
ç) pasojat e ardhura;
d) shpeshtësinë e kryerjes së shkeljes;
dh) elemente të tjera në varësi të rastit konkret.

Neni 111
Verifikimi i kryerjes së procedurave të prokurimit dhe monitorimi i zbatimit të kontratave

1. APP-ja kryen hetim administrativ për zbatimin e legjislacionit për prokurimin publik, lidhur me:

   a) kryerjen e procedurave të prokurimit publik, pas nënshkrimit të kontratës ose kryerjen e procedurave pas anulimit të procedurës së prokurimit;
   b) ecurinë e zbatimit të kontratave publike.

2. Hetimi administrativ kryhet në përputhje me nenin 129, të LPP-së, dhe Kodin e Procedurave Administrative.

   Ky hetim mund të iniciohet kryesisht nga APP-ja ose në bazë të pretendimeve të argumentuara dhe dokumentuara nga të tretët. Çdo kërkesë e paraqitur në APP nga të tretët duhet të jetë e nënshkruar dhe e shoqëruar me dokumentacionin provues.[110]

3. Në përfundim të hetimit administrativ, kur vëren se janë shkelur dispozitat ligjore të prokurimit dhe rregullat e prokurimit publik, APP-ja mund të vendosë të dënojë me gjobë ose të propozojë dhënien e masave disiplinore, sipas parashikimeve të nenit 132, të LPP-së.

4. Në çdo rast, për vendosjen e masës së gjobës apo propozimit të një prej masave disiplinore, kur vëren shkelje të dispozitave të LPP-së, APP-ja duhet t'u referohet të paktën elementeve të mëposhtme:

   - rolit të zyrtarit të prokurimit dhe kompetencave në vendimmarrje;
   - vlerës së përllogaritur të fondit limit/kontratës;
   - parimeve të prokurimit që janë shkelur;
   - natyrës së shkeljes;

[110] Shtuar me VKM 498/2024

- pasojave të ardhura;
- përsëritjes së shkeljeve në raste të tjera, ose procedurave të tjera;
- elementeve të tjera objektive, që APP i evidenton dhe argumenton në vendimmarrjen e saj.

5. Pasi merr një vendim në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla, APP-ja duhet t'ia njoftojë vendimin autoritetit/entit kontraktor.

   Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin t'u njoftojë vendimin e dhënë nga Agjencia e Prokurimit Publik personave të përfshirë në hetimin administrativ dhe të dokumentojë këtë njoftim.

   Autoriteti/enti kontraktor përkatës ka detyrimin të informojë APP-në për zbatimin e masave të vendosura sipas këtij neni, brenda afatit kohor të përcaktuar prej saj.

Neni 112
Komunikimi, publikimi dhe ankimi i vendimmarrjes së Agjencisë së Prokurimit Publik

1. APP-ja i njofton vendimin përfundimtar palëve brenda ditës pasardhëse të punës nga marrja e vendimit.

2. Një përmbledhje me të dhënat kryesore për vendimin përfundimtar publikohen në faqen zyrtare të APP-së për çdo të interesuar.

3. Vendimet e dhëna nga APP-ja janë përfundimtare administrativisht dhe personat e interesuar kanë të drejtën të ankohen në gjykatën përkatëse, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative.

Neni 113
Refuzimi për bashkëpunim

Refuzimi i autoritetit/entit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe/ose Agjencinë e Prokurimit Publik ose moszbatimi brenda afatit i vendimeve të këtyre të fundit në mënyrë të pajustifikuar [111]ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit/entit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

[111] Shtuar me VKM 498/2024

Neni 114
Përgjegjësia penale

Sanksionet administrative dhe masat disiplinore nuk përjashtojnë përgjegjësinë penale të personit që ka kryer shkeljet.

KREU XV
MANUALET DHE TRAJNIMI

Neni 115
Udhëzime dhe manualet shpjeguese

APP-ja harton udhëzime dhe manuale shpjeguese për t'u ardhur në ndihmë të gjitha palëve gjatë kryerjes së veprimtarive të prokurimit.

Neni 116
Ngritja e kapaciteteve

1. APP-ja bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve për institucionet publike, me qëllim ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionalizimin e sistemit të prokurimit publik në përgjithësi.

2. APP-ja bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për hartimin e një plani trajnimi në fushën e prokurimit publik, bazuar në kërkesat e nevojat për trajnim, si dhe në hartimin e kurrikulave përkatëse.

Neni 117
Dispozita transitore

1. Procedurat e prokurimit të nisura para hyrjes në fuqi të këtij vendimi vazhdojnë sipas rregullave të prokurimit publik, në bazë të të cilave ato janë shpallur.

2. Verifikimi i procedurave të prokurimit nga APP-ja bazohet në gjetjet e evidentuara sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi në kohën e zhvillimit të procedurave dhe vendimmarrja për këto procedura do të bazohet në dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi në kohën e dhënies së vendimit.

Dispozita kalimtare[112]

[112] Sipas neni 52 "Dispozita Kalimtare" te VKM 498/024

1. Procedurat e prokurimit të filluara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi vazhdojnë sipas rregullave të prokurimit publik, në bazë të të cilave ato kanë filluar.

2. Në rast se, një autoritet/ent kontraktor pas marrjes së autorizimit nga Këshilli i Ministrave, ka negociuar drejtpërdrejt një marrëveshje konsulence me subjekte ndërkombëtare, sipas parashikimeve në pikën 2, të nenit 52, të ligjit nr.16/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020, "Për prokurimin publik", dërgon një njoftim në Agjencinë e Prokurimit Publik, për periudhën kalimtare 3-vjeçare.

3. Kryerja e tranimit të detyrueshëm bazë dhe certifikimi pas kalimit me sukses të testimit përkatës për personat përgjegjës apo zyrtarët e strukturave organizative të prokurimit publik, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij vendimi, do të kryhet brenda 2 (dy) viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Gjatë 2 viteve të para pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike merr masa për zhvillimin e testimeve në intervale të rregullta 2 mujore.